

Të Rinjtë Rom në Veprim

Kërkim me Pjesëmarrje

Raport Rajonal



Të Rinjtë Rom në Veprim

Kërkim me Pjesëmarrje

Raport Rajonal

Ky raport është publikuar në kuadër të projektit rajonal “Liderët – e Rinj Romë në Veprim”, i financuar nga Departamenti i Shtetit, i menaxhuar dhe i vënë në zbatim nga zyrat e Save the Children në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, në një bashkëpunim të ngushtë me partnerët lokalë Roma Active Albania dhe Iniciativa 6.

Përgatitur nga

Dr. Ada Huibregtse
Konsulente për Zhvillimin e Raportit Rajonal

Përmbajtje

| | |
|--|----|
| Akronime dhe Shkurtime | 3 |
| Falënderime | 4 |
| Përmbledhje | 6 |
| Hyrje | 10 |
| Qëllimet e Raportit | 12 |
| Metodologjia | 13 |
| Struktura e raportit..... | 20 |
| Përshkrimi i projektit LYRA..... | 22 |
| Përmbledhja e rezultateve të Projekteve Kombëtare Kërkimore me pjesëmarrje..... | 24 |
| Diskriminimi ndaj të rinjve romë | 24 |
| Përjashtimi social i të rinjve romë..... | 29 |
| Edukimi | 37 |
| Mbështetja për fuqizimin e të rinjve romë..... | 41 |
| Konkluzione..... | 49 |
| Rekomandime | 53 |
| Bibliografia | 57 |

AKRONIME DHE SHKURTIME

| | |
|-----------------|--|
| AR | Projekt kërkimor me pjesëmarrje |
| CRC | Konventa mbi të drejtat e Fëmijëve |
| HandiKOS | Shoqata e Fëmijëve Paraplegjikë dhe të Paralizuar të Kosovës |
| LSMS | Indeksi i jetëgjatësisë, arsimit dhe standardeve jetësore |
| LYRA | Liderët – Të Rinjtë Romë në Veprim |
| NGO | Organizata joqeveritare |
| RAA | Roma Active në Shqipëri |
| SC | Save the Children |

FALËNDERIME

Zhvillimi i këtij raporti mbi diskriminimin, përjashtimin social dhe edukimin e të rinjve romë, egjiptianëve dhe ashkali në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë u bë i mundur falë Departamentit amerikan të Shtetit dhe Save the Children SHBA. I falënderojmë ata si dhe popullin amerikan për kontributin e tyre në fonde dhe ekspertizën e nevojshme teknike për realizimin e këtij projekti.

Një sërë organizatash qeveritare, jo qeveritare si dhe individë nga të tri vendet kanë kontribuar në zbatimin këtij projekti të madh. Save the Children në Shqipëri, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët vendorë *Rome Active Albania* dhe *Iniciativa 6*, punuan për të hartuar planin dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të projektit rajonal. Kjo punë e gjerë u udhëhoq nga kolegët e Save the Children, Edlira Ngjeçi (Shqipëri), Amir Bašić (Bosnje-Hercegovinë), dhe Genta Gagica (Kosovë). Falënderime të veçanta i kushtohen gjithë aktorëve që kanë marrë pjesë në hulumtim: komuniteteve romë dhe jo romë, fëmijëve, prindërve, organizatave, OJQ-ve lokale dhe institucioneve publike. Duam gjithashtu të shprehim mirënjohjen tonë ndaj organizatave lokale në Bosnje Hercegovinë, të cilat kanë dhënë ndihmesën e tyre të vazhdueshme në realizimin lokal dhe kombëtar të studimeve, si dhe për komentet dhe rishikimin e këtij raporti: Nova Generacija në Banja Luka, Otaharin në Bijeljina, Altruist në Mostar, dhe Centre for Social Work në Kantonin e Sarajevës.

Një falënderim të veçantë për anëtarët romë dhe jo romë e ekipit LYRA dhe komuniteteve në të tre vendet. Pa angazhimin dhe punën e kryer prej tyre, ky program nuk do të mund të zbatohet me sukses. Emrat e romëve e jo romëve të rinj të përfshirë në këtë projekt janë ndarë sipas shteteve e radhitur më poshtë.

Shqipëri

Alesion Çela, Altin Rushit, Andi Ymeri, Anxhela Buzi, Anxhela Nofulla, Anjeza Kazanxhiu,

Ardit Kasmollari, Ardita Çela, Armand Isuf, Asije Ali, Blerta Uthulla, Danjel Hyseni, Denada Koci, Denisa Trimi, Dorina Hajdinllari, Eglantin Aliko, Eneo Metani, Erion Kullozi, Erald Rushit, Erisa Kazanxhiu, Ervin Sinani, Floresha Ali, Kristi Mejdani, Kristi Kosina, Makelian Haxhiaj, Mariglen Bino, Mateo Muhaxhiri, Mikelian Selimaj, Nebi Kazanxhiu, Renart Koci, Romina Lutaj, Rudina Kiptiu, Xhuljano Tifi.

Bosnje-Hercegovina

Admira Biberović, Ahmet Sejdović, Almir Hidanović, Bahrudina Ramić, Begzada Beganović, Borijana Planinčić, Damira Alimanović, Denis Mujić, Dijana Lazarević, Dragana Vidljanović, Edin Sejdović, Elvis Cero, Emina Ramić, Fatima Džanić, Gazmend Januzi, Luca Aleksić, Martina Glavaš, Marko Božić, Medina Bešić, Milenko Jovanović, Nataša Pivašević, Nehrudin Čikarčić, Nermin Gazija, Ognjen Tadić, Ramiz Beganović, Ramiz Spasoli, Sanel Bislimi, Sanela Sujoldžić, Senad Dorović, Senija Smoljić and Toni Kolar.



Kosovë

Adelina Kabashi; Alban Morina; Albertina Monika; Amir Osmani; Avnore Morina; Besart Mersula; Bleta Qehaja; Bujar Luboja; Dardan Fetahaj; Egzon Sehari; Erxhan Sehari; Fatlum Kryeziu; Furkan Ago; Gezim Qehaja; Granit Hoxha; Ilajda Qorri; Jemina Osmani; Lavdim Morina; Majlinda Shala; Masar Derri; Mirjeta Qehaja; Nita Efendia; Nuhi Morina; Resul Milaimi; Rreze Oseku; Sanije Mergjollar; Valon Gashi; Vilson Dura; Ylveha Braha and Zejnepe Qabrati.

PËRMBLEDHJE

Ky raport nënvizon **ndërhyrjet afatgjata, të harmonizuara në nivele e sektorë të ndryshëm**, për të reduktuar diskriminimin dhe përjashtimin social të romëve të rinj, atyre ashkali dhe egjiptianë në Shqipëri, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë. Themelet për një pjesëmarrje aktive dhe integrimin e romëve dhe jo romëve të rinj në përpjekjet e komunitetit të tyre janë hedhur përmes projektit LYRA, por është e nevojshme një mbështetje e mëtejshme për të nxitur ndryshime të vazhdueshme në mentalitetet dhe sjelljet, të cilat do të sigurojnë qëndrueshmërinë e këtyre themeleve.

*Një planifikim i mirë, sistematik dhe i vazhdueshëm i aftësive praktike të të rinjve romë dhe jo romë, në mënyrë që ata të bëhen qytetarë aktivë dhe të ndryshojnë jetën e tyre në një mënyrë të dëshirueshme, ka qenë gjithmonë burim rezultatesh pozitive, pavarësisht nga përkatësia etnike apo sociale. Të rinjtë romë dhe jo romë dinë të mirëpresin mundësitë e ofruara nga **Save the Children** për rritjen e tyre individuale dhe e kanë përdorur atë për të ndihmuar komunitetet e tyre, për të përmirësuar jetën e tyre dhe për të hapur rrugë të reja komunikimi dhe bashkëpunimi me komunitetet e tjera jo romë.*

Përjashtimi dhe diskriminimi i **pengojnë** të rinjtë romë në **zhvillimin e plotë** të kapaciteteve të tyre akademike, sociale dhe fizike për të ndërtuar më tej një jetë të pavarur dhe frytdhënëse, që do të jenë të dobishme për përmirësimin politik, ekonomik dhe social të vendeve dhe rajonit të tyre. Veprimi rajonal brenda kontekstit të Anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe instrumenteve të politikave të Bashkimit Europian mund të jenë të frytshme në promovimin e përfshirjes sociale dhe mos diskriminimin e të rinjve romë.

Pavarësisht nga një legjislacion në përgjithësi i përshtatshëm dhe vëmendjes politike mbi këtë çështje, të rinjtë romë në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, dhe Kosovë e gjejnë veten të diskriminuar dhe të përjashtuar në nivel individual, institucional dhe atë shoqëror. Edhe pse

nuk ka politika apo rregullore diskriminuese dhe përjashtime institucionale, paragjykimet individuale e shoqërore ndaj të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë janë bartur në institucionet publike si rezultat i sjelljeve apo qëndrimeve diskriminuese dhe përjashtuese të punonjësve në institucionet publike.

Nëpër **shkolla** ekziston një **diskriminim** dhe **përjashtim i përhapur** i të rinjve romë, ashkali dhe atyre egjiptianë. Shkalla e braktisjes së shkollimit nga ana e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve është më e lartë se ajo e jo romëve. Aktivitetet jashtëshkollore ndiqen më pak nga romët, ashkalitë dhe egjiptianët se sa nga fëmijët e tjerë. Ndërsa politikat arsimore mund të diferencojnë pozitivisht romët, ashkalitë dhe egjiptianët, për të nxitur përmirësimin e tyre akademik si dhe përfshirjen e tyre sociale, disa mësues i përdorin në mënyrë negative, duke përforcuar paragjykimet shoqërore kundër këtyre grupeve. Të rinjtë romë, ashkali dhe egjiptianë kanë **më pak përfitime** nga sistemet arsimore ekzistuese sesa të rinjtë e tjerë.

Statistikat e ndara sipas përkatësisë etnike pothuajse nuk ekzistojnë ose janë të një cilësie të dobët. Të dhënat e mbledhura nga hulumtuesit e LYRA-s nuk janë gjithmonë të përgjithësuese, por në qoftë se përdoren me kujdes ato mund të nxjerrin në pah fushat ku ka një nevojë të menjëhershme për të dhëna rreth popullsisë rome, ashkali dhe egjiptiane, të cilat mund të përdoren më tej për të kuptuar saktë edhe problemet me të cilat përballen këto popullsi. Politikat bazuar mbi dëshmi kanë nevojë për të dhëna të një cilësie më të lartë e të zërthyer sipas përkatësive etnike.

Pakicat rome, egjiptiane dhe ashkali kanë një mungesë në vetëdije për të kuptuar diskriminimin e praktikuar ndaj tyre. Përveç ligjeve dhe politikave me qëllim për të ulur diskriminimin e këtyre grupeve, popullsia rome, ashkali dhe egjiptiane duhet të pajiset me njohuri dhe aftësi për të identifikuar diskriminimin kundër tyre e për ta luftuar sa më mirë atë. Nëse programet ndërgjegjësuese të fokusuara tek fëmijët dhe të drejtat e njeriut, si dhe rritja e ndërveprimeve mes popullsisë rome dhe jo rome, drejtohen në mënyrën e duhur, atëherë ato mund të jenë të favorshme për mos diskriminimin dhe përfshirjen e të rinjve romë.

Diskriminimi gjinor, i cili lulëzon mbi themelet kulturore dhe ekonomike, është i përhapur tashmë në të tri vendet. Projekti kërkimor me pjesëmarrje në Kosovë ka

nxjerrë në pah se diskriminimi gjinor ndodh veçanërisht shpesh në gjirin e popullsisë rome, ashkali dhe egjiptiane. **Vajzat** janë subjekt i **martesave të hershme** më shpesh se djemtë në komunitetet rome, egjiptiane dhe ashkali dhe si rezultat ato kanë më pak vite shkollimi dhe e braktisin shkollën më shpesh se djemtë romë, egjiptianë dhe ashkali.

Të rinj romë, ashkali dhe egjiptianë janë **të përjashtuar**, nuk përfshihen shoqërisht në fushat ekonomike, identitare, gjinore dhe politike. Shumica e të rinjve romë dhe familjet e tyre jetojnë në nivelin e varfërisë, janë të papunë ose të punësuar në të zezë. Në Bosnje-Hercegovinë disa të rinj romë dhe familjet e tyre kanë vështirësi në marrjen e kartës së identitetit ose të dokumentit të udhëtimit për shkak të mungesës së informacionit apo të shtetësisë së huaj.

Të rinjtë romë dhe egjiptianë në Shqipëri **nuk janë të përfshirë në pushtetin vendor**. Përjashtimi politik sjell edhe mos angazhimin e mëtijshëm social dhe politik brenda komuniteteve rome dhe egjiptiane duke dobësuar edhe më tej përfshirjen e tyre sociale. **Përfshirja sociale** e fëmijëve me aftësi të kufizuara romë dhe jo romë është një domosdoshmëri. Ligjet dhe politikat janë të favorshme për përfshirjen e tyre sociale, por zbatimi i tyre është ende i kufizuar për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore. Nëse lihen të pa trajtuar, fëmijët me aftësi të kufizuara do të gjenden në një situatë gjithnjë e më të përkeqësuar.

Qëndrueshmëria e aksioneve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve për të përmirësuar jetën e tyre, për të reduktuar diskriminimin, për të marrë pjesë plotësisht politikisht, shoqërisht dhe ekonomikisht në shoqërinë e vendeve të tyre mund të bëhet realitet vetëm kur një masë kritike të rinjsh nga këto komunitete të kenë njohuritë dhe aftësitë për të filluar, zbatuar dhe finalizuar vetë këto projekte. Romët, ashkalitë dhe egjiptianët në të tre vendet janë sipërmarrës të aftë edhe në situata të pafavorshme. Nxitja e shpirtit të tyre sipërmarrës falë transferimit të njohurive të menaxhimit të biznesit dhe aftësive profesionale do t'i ngrejë të rinjtë romë në një nivel konkurrues në tregun e punës, qoftë si profesionistë apo si sipërmarrës.

Ka nevojë për hulumtime të mëtijshme rajonale për të përcaktuar veprimet dhe politikat më efikase për **reduktimin e diskriminimit** dhe **rritjen e përfshirjes sociale**. Për një qasje rajonale, studiuesi duhet të përdorë metodologjinë dhe instrumente të unifikuar për

të siguruar një krahasueshmëri mes vendeve dhe me themele më të forta me pjesëmarrje politike dhe advokuese në nivel rajonal.

Plani rajonal i advokimit i ngritur nga LYRA, përbën një dokument strategjik koordinimi mes liderëve të rinj, i cili sugjeron se reduktimi i diskriminimit të të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim, promovimi i përfshirjes sociale për fëmijët dhe të rinjtë romë në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal, si dhe regjistrimit civil i të rinjve romë janë hapat e parë që duhen ndërmarrë për fuqizimin e tyre.



HYRJE

Ky raport është një **dëshmi e fuqizimit të suksesshëm të të rinjve** romë përmes procesit kërkimor me pjesëmarrje¹ në: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë si pjesë e projektit LYRA - Liderët e Rinj Romë në Veprim - i zbatuar në bashkëpunim me Save the Children dhe Partnerët e projektit - Roma Active Albania (RAA) dhe Iniciativa 6, i financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Të papërgatitur për të kryer procesin kërkimor me pjesëmarrje (AR), të rinjve romë, egjiptianë, ashkali² dhe jo romë, në këto tre vende u janë siguruar **mjete praktike dhe teorike** për të identifikuar dhe adresuar shqetësimet kryesore të të rinjve në komunitetet e synuara rome, në mënyrë që ata të jenë në gjendje **përtë ndërmarrë veprime efektive dhe efikase** për të përmirësuar përfshirjen sociale dhe për reduktuar diskriminimin, si dhe për të rritur mbrojtjen e popullsisë rome në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ndarja e qëllimeve, njohurive, të mjedisit të punës dhe praktikës, si pjesë e aktiviteteve të projektit, i ka ndihmuar këta të rinj, jo vetëm të fitojnë një grup aftësish të nevojshme për të kryer kërkimin dhe advokimin e tyre, por edhe për t'i zhytur ata në mënyrën e jetesës dhe të menduarit të tjetrit.

Kjo mënyrë ka zgjeruar sferën e të kuptuarit të pjesëmarrësve romë e jo romë në lidhje me çështjet me të cilat përballen të rinjtë romë dhe komunitetet e tyre. Kjo ka rezultuar në gjetje dhe sugjerime të cilat pasqyrojnë në përgjithësi shqetësimet, mendimet, perceptimet dhe sugjerimet nga komuniteti rom dhe në veçanti të të rinjve romë për të trajtuar problemet me të cilat përballen komuniteti rom e ndonjëherë dhe ai jo rom.

Procesi i kërkimit me pjesëmarrje nuk ishte aspak i lehtë për shkak se shumë pjesëmarrësve u mungonte përvoja paraprake dhe njohuritë e nevojshme për procesin, analizimin e koncepteve të reja e të panjohura, informacionin dhe përdorimin e metodave kërkimore

me pjesëmarrje. Fitimi i besimit të komuniteteve rome dhe qasja e përfaqësuesve të institucioneve të rëndësishme ishte gjithashtu i vështirë në zbatimin e projektit. Në disa raste ekipet e LYRA-s u dhanë më shumë peshë veprimeve për të zgjidhur problemet sesa metodologjisë së hulumtimit për t'i identifikuar ato.

Megjithatë, procesi në vetvete ishte gjithmonë në rritje.

Disa nga këto dobësi u tejkaluan nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm rajonal dhe lokal mbi procesin e kërkimit me pjesëmarrje, duke përfshirë metodologjinë, komunikimin, lidershipin, punën në ekip dhe advokimin.

Shumë të rinj romë dhe jo romë u bashkuan në përgjithësi me programin LYRA si qytetarët të paangazhuar me ose pa interes të dukshëm apo përfshirje aktive në jetën e pjesëtarëve të bashkësisë së tyre. Por dolën ngaky proces si qytetarë të angazhuar, të fuqizuar me njohuri dhe mjete për të shqyrtuar problemet e komuniteteve të tyre dhe plot besim në vetvete se tashmë mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Pjesëmarrësit në projektin LYRA konstatuan se romët janë të përjashtuar nga shoqëria dhe të diskriminuar në një nivel individual nga ana e popullsisë jo rome, madje ndonjëherë edhe brenda bashkësisë së tyre. Në disa raste ekziston gjithashtu dhe një përjashtimi social dhe një diskriminim në nivelin institucional dhe ligjor.

Shumë romë jetojnë në varfëri ekstreme. Të rinjtë romë, por edhe të rriturit romë gjithashtu, mungojnë në forcat e afta për punë në çdo sektor madhor, por edhe në profesione të pavarura. Ata kanë nivel të ulët arsimor, një përqindje më të lartë të braktisjes së shkollës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në raport me popullsinë jo rome. Edhe pse nuk ka diskriminim ligjor në edukimin e fëmijëve romë, ky diskriminim ndaj fëmijëve romë bëhet individualisht nga mësuesit dhe përjashtimi social nga vetë shkolla përmes mosveprimit. Romët kanë njohuri të dobëta pune si rezultat i një edukimi të dobët.

Ka mangësi të dukshme në regjistrimin civil dhe të dhënave të autorizuara për komunitetin rom, gjë që nuk i lejon qeveritë të veprojnë apo i justifikon për mosveprimin e tyre për të adresuar dhe zgjidhur problemet e romëve.

Shumë të rinj, por sidomos vajzat rome, martohen në një moshë shumë të hershme duke pakësuar kështu shanset e tyre për arsimim, për një shëndet të mirë dhe një përfshirje më të thellë sociale dhe civile në shoqëri. Shumë të rinj dhe të rritur romë nuk e kanë të qartë konceptin e diskriminimit dhe si rezultat ata shpesh nuk e kuptojnë që diskriminohen. Përfshirja sociale, qytetare dhe politike e romëve është në rastin më të mirë e pamjaftueshme dhe në rastin më të keq nuk ekziston fare. Fëmijët romë me aftësi të kufizuara janë të përjashtuar nga shoqëria dhe të diskriminuar vetëm nga fakti i dukshëm se ka shumë pak shkolla që mund të ofrojnë një arsimim po aq të mirë e me cilësi përfshirëse siç iu ofrohet fëmijëve të tjerë. Megjithatë ekipet e LYRA-s konstatuan se asnjë nga këto shprehje përjashtimi social dhe diskriminimi nuk janë të një natyre ligjore.

Qëllimet e Raportit

Ky raport bën thirrje **për fuqizimin e mëtejshëm** të të rinjve romë dhe integrimin e tyre në shumicën jo rome.

Më tej ky raport nënvizon se **zhvillimi i kapaciteteve** është ***një mjet kyç*** për fuqizimin e të rinjve romë për të marrë të tashmen dhe të ardhmen e tyre në dorë.

Ky raport identifikon disa nga çështjet që popullata rome i sheh si më të rëndësishmet në rritjen e **përfshirjes së tyre sociale** si dhe **nëzbehjen e diskriminimit** ndaj tyre. Ai përfshin gjithashtu **raste studimore** të përzgjedhura të ndërhyrjeve të komunitetit të ndërmarra nga liderët e të rinjve për të adresuar çështjet e identifikuar.

Konkretisht, ky raport ka për qëllim:

- Të sigurojë prova të përfshirjes së suksesshme të të rinjve romë në identifikimin dhe adresimin e problemeve që ata hasin si komunitet;
- Të tregojë se të rinjtë romë dhe jo-romë mund të punojnë së bashku në ekipe duke kuptuar edhe më mirë problemet me të cilat përballen;
- Të identifikojë çështjet kryesore me të cilat përballen komunitetet rome nga këndvështrimi i romëve dhe përfaqësuesve të institucioneve;

- Të sigurojë të dhënat fillestare ose shtesë në lidhje me komunitetet e synuara rome dhe të identifikojë problemet të cilat janë kritike për komunitetin rom.
- Të inkurajojë donatorët dhe zbatuesit e interesuar për të mbështetur iniciativa të ngjashme në koncept (rritjen e kapaciteteve) dhe/ose në zbatim (të mësuarit në praktikë) me projektin LYRA, dhe të theksojë se pjesës kërkimore duhet t'i përkushtohet po aq vëmendje sa veprimit dhe fazave të mëtejshme të advokimit.
- Të nënvizojë se një mbështetje e tillë për të rinjtë romë duhet të vazhdojë në mënyrë që të krijohet një masë kritike të rinjsh romë, të cilët të jenë të përgatitur dhe të interesuar për të marrë pjesë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të komuniteteve të tyre.
- Të propozojë në nivel rajonal mesazhet e aplikueshme të advokimit dhe zgjidhjet të cilat duhen adresuar në mënyrë efektive mbi çështjet e identifikuar.

Metodologjia

Ky raport përdor triangulacionin si metodë për të analizuar të dhënat cilësore dhe sasiore të mbledhura nga raportet kombëtare kërkimore me pjesëmarrje mbi të rinjtë romë në Shqipëri,³ Bosnje Hercegovinë⁴ dhe në Kosovë⁵, si dhe nga raportet lokale kur është e nevojshme, nga konsultimet me ekipet e LYRA-s gjatë trajnimit rajonal në shkurt të vitit 2014, ose nga shkëmbimet nëpërmjet e-mailit, me stafin e Save the Children dhe RAA-së, por gjithashtu duke përdorur dhe literaturën përkatëse e cila është e domosdoshme për të hedhur dritë mbi variablat teorike apo kontekstuale, për të qartësuar përshtatshmërinë dhe rëndësinë e informacionit të mbledhur gjatë procesit kërkimor me pjesëmarrje.

Raportet Kombëtare mbi procesin kërkimor me pjesëmarrje në të tre vende ishin një rezultat i të dhënave dhe punës së advokimit të kryer nga ekipet e LYRA-s në bashkëpunim me Save the Children, partnerët e tyre (RAA në Shqipëri dhe Iniciativa 6 në Kosovë) si dhe ekspertët në fushën e procesit kërkimor me pjesëmarrje dhe advokim. Raportet lokale ishin produkt i çdo ekipi kërkimor me pjesëmarrje të LYRA-s, të cilët ishin përqendruar në një ose më shumë problematika me të cilat ballafaqohet një komunitet rom.

Ekipet kërkimore me pjesëmarrje të LYRA-s përdorën metodologjinë e hulumtimit të veprimit për të identifikuar problemet e për të mbledhur të dhënat. Të rinjtë romë, anëtarë

të ekipit, ishin gjithashtu dhe pjesëtarë të komuniteteve rome të synuara duke favorizuar përfshirjen e mëtejshme të komuniteteve të tyre në identifikimin e problematikave. Ky projekt e zgjeroi idenë e kërkimit me pjesëmarrje në një hulumtim integruar të veprimit, ku ekipet e të rinjve jo-romë e romë hulumtuan problematikat e komuniteteve të tyre, duke konstatuar se disa prej tyre nuk janë thjesht probleme “rome”, për shkak se ato prekin dhe ndikojnë popullatat rome dhe jo-rome në secilin prej vendeve pjesëmarrës.

Procesi i kërkimit me pjesëmarrje u krye në nivel lokal nga një ekip i gjerë i përbërë nga të rinj romë dhe jo-romë në Shqipëri (33), Bosnje-Hercegovinë (75) dhe Kosovë (28). Nuk ishte aspak e lehtë për të ngritur ekipe me anëtarë të cilët nuk kishin një përvojë pjesëmarrëse dhe kërkimore dhe kjo si pasojë e një angazhimi të ulët të të rinjve romë në jetën qytetare; mungesa e përvojës së tyre në projekte kërkimore me pjesëmarrje është rrjedhojë e përqindjes së lartë të braktisjes të studimeve në fund të ciklit fillor apo gjatë shkollës së mesme. Pra, për zbatimin e këtij projekti, ishte e nevojshme të ndërtohej një masë kritike të rinjsh romë që të kishin aftësitë e duhura për të qenë një pjesë integrale e projektit. Për më tepër, për të krijuar një ndërveprim kuptimplotë mes të rinjve romë dhe jo-romë, këta të fundit u ftuan të aplikonin për të qenë pjesëtarë të ekipeve kërkimore me pjesëmarrje. Në një kontekst shoqëror ku ka pak ndërveprim dhe shkëmbim idesh dhe njohurish midis të rinjve romë dhe jo-romë, një qasje integruarë kërkimore me pjesëmarrje mund të ishte e dobishme për bashkëpunim mes të rinjve me identitete të ndryshme etnike. Siç tregon përvoja shqiptare dhe boshnjake, nuk ishte e lehtë identifikimi i të rinjve romë, të cilët plotësonin të gjitha kriteret për pjesëmarrje, dhe disa të rinj u përfshinë në projekt me kusht që të vazhdonin shkollën dhe të përfundonin vitin shkollor.

Meqenëse masa kritike e të rinjve romë dhe jo romë për zbatimin e këtij projekti u arrit në të tre vendet, Save the Children trajnoi gjashtëdhjetë liderët e rinj mbi metodat kërkimore me pjesëmarrje gjatë një sesioni pesë ditor të titulluar “Hapat drejt fuqizimit” të mbajtur në Tiranë në prill të vitit 2013. Njohuritë dhe aftësitë e prezantuara gjatë këtij trajnimi iu shpërndanë si rrjedhojë dhe udhëheqësve të tjerë të rinj të komuniteteve të të tre vendeve ku u krye ky studim. Të gjashtëdhjetë Liderët e rinj të trajnuar në Tiranë, trajnuan 132 të rinj të tjerë gjatë disa seminareve në vendet ku hulumtimi me pjesëmarrje u vu në zbatim.

Komunitetet e synuara, pyetjet kërkimore dhe sasia e kampionit

- ✓ Dymbëdhjetë komunitete në Ballkanin Perëndimor (pesë komunitete në Shqipëri, pesë në Bosnjë-Hercegovinë dhe dy komunitete në Kosovë) u përzgjedhën për të kryer këtë projekt kërkimor me pjesëmarrje.
- ✓ Çdo ekip kërkimor me pjesëmarrje i LYRA-s zgjodhi tematikat që përbënin interes duke u konsultuar me komunitetet e synuara.
- ✓ Instrumentet kryesore për të mbledhur të dhënat kanë qenë intervista ballë për ballë, sondazhe dhe fokus grupe.

Shqipëria

- Në Shqipëri, komunitetet e synuara janë të vendosura në Baltëz, Levan, Korçë, Pogradec dhe Roskovec. Ekipi i LYRA-s ka intervistuar gjithsej **212** persona.



- Në Baltëz, ku banojnë rreth 300 të rinj romë, ekipi LYRA vendosi të hulumtojë efektet e mungesës së transportit publik në arsimimin dhe punësimin e të rinjve. Ekipi plotësoi 52 pyetësorë me të rinj romë dhe jo-romë.
- Në Levan, ku banojnë 840 romë, sipas studimeve ekzistuese⁶, ekipi LYRA vendosi të hulumtojë shkaqet e braktisjes së arsimit bazë. Ata kryen vizita në 300 familje në Levan, plotësuan 30 pyetësorë me romë dhe jo-romë dhe zhvilluan intervista me drejtorin e shkollës, mësuesit, si dhe punonjësit e Drejtorisë Arsimore Rajonale. Sipas ekipit AR në Levan, kjo njësi është populluar nga 2500 romë.
- Në Korçë, ekipi LYRA vendosi të hulumtojë mbi përfaqësimin e të rinjve romë në pushtetin vendor. Ekipi plotësoi 80 pyetësorë me romë dhe jo-romë dhe gjashtë intervista me zyrtarë të pushtetit vendor.

- Në Pogradec, banojnë 167 familje rome. Ekipi LYRA vendosi të hulumtojë identifikimin dhe etiketimet diskriminuese në shkollën e mesme «Kozma Gjok Basho», si shkollë rome. Ekipi plotësoi 30 pyetësorë; 20 fëmijë romë dhe jo-romë të moshës 11-14 vjeç dhe 10 me fëmijët që kanë lënë ose braktisur këtë shkollë, si dhe intervista me drejtorin e shkollës «Kozma Gjok Basho», specialistë të arsimit dhe planifikimit të zyrës lokale të arsimit, kreun e këshillit të shkollës dhe prindërit e fëmijëve që kishin lënë shkollën. Ekipi kreu një fokus grup me ish-nxënës që kishin braktisur shkollën në fjalë. Ata bënë gjithashtu foto të shkollave të ndryshme nëntë-vjeçare në Pogradec për t'i krahasuar me kushtet e shkollës së synuar.
- Në Roskovec, banojnë rreth 157 romë, ekipi LYRA vendosi të hulumtojë mbi mundësitë e krijimit të një qendre rinore. Ekipi plotësoi 30 pyetësorë: 15 me romë dhe 15 me të rinjtë jo-romë të moshës 16-26 vjeç. Gjithashtu kryen një fokus grup me 13 pjesëmarrës të grup moshave të ndryshme dhe një intervistë me kryetarin e bashkisë së Roskovecit.

Bosnje-Hercegovinë



Në Bosnje-Hercegovinë, komunitetet e synuara janë të vendosura në Banja Luka, Bileljina, Mostar, Sarajevë dhe Tuzla. Projekti LYRA mbuloi të pesë komunitetet, sepse ata kanë një popullsi të dendur, si dhe komunitetin rom më të madh në vend. Në total ekipi LYRA intervistoi **262** romë dhe egjiptianë dhe 19 përfaqësues të institucioneve të ndryshme duke mbledhur gjithashtu dhe informacion në lidhje me 385 persona, prej të cilëve 362 janë romë dhe egjiptianë.

- Në Banja Luka jetojnë 200 romë të stabilizuar. Ekipi LYRA vendosi të identifikojë problemet kryesore të komunitetit rom. Ata plotësuan 62 intervista, 39 prej të cilave me romë.
- Në Bijeljina, banojnë 270 familje rome, ekipi LYRA vendosi të hulumtojë qëndrueshmërinë

në sistemin arsimor të fëmijëve dhe të rinjve romë. Ekipi plotësoi 50 intervista me prindërit dhe fëmijët romë dhe 10 intervista shtesë me përfaqësues të institucioneve të arsimit.

- Në Mostar, banojnë rreth 500 romë, 150 prej të cilëve kanë ardhur nga Kosova dhe kanë status refugjati. Ekipi LYRA vendosi të krijonte një hartë sociale të vendbanimeve të pa favorizuara sociale të romëve në Karašerbeš dhe Novo Naselje. Ekipi mblodhi të dhëna mbi 96 romët e Karašerbeš-ës dhe 60 romët në Novo Naselje.
- Në Sarajevë ekipi LYRA vendosi të hulumtojë mbi përfshirjen sociale të të rinjve romë. Ekipi plotësoi 50 pyetësorë me romë (28 meshkuj dhe 22 femra) të moshës 13 deri 20 vjeç. Përveç kësaj, ekipi LYRA zhvilloi dhe intervista me përfaqësues nga disa shkolla e klube sportive dhe baleti.
- Në Tuzla banojnë më shumë se 5000 romë, ekipi LYRA vendosi të hulumtojë mbi diskriminimin e popullsisë rome në lidhje me shpërndarjen e informacionit, migrimin, punësimin dhe shëndetin. Ekipi plotësoi 71 intervista, ku 67 të anketuarit janë romë.

Kosovë



Në Kosovë, komunitetet e synuara nga ky studim janë të vendosura në Gjakovë dhe Prizren. Ekipet e LYRA-s mblodhën informacion mbi **1052** të rinj romë, ashkali dhe egjiptianë të moshës nga 6 deri në 22 vjeç.

- Në Gjakovë, banojnë rreth 600 romë, 6080 ashkali dhe një numër i papërcaktuar egjiptianësh, kështu që ekipi LYRA vendosi të hulumtonte mbi dy çështje:
 - E para duke u përqendruar në diskriminimin ndaj të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë nga ana e mësuesve. Ekipi LYRA mblodhi informacion mbi 346 të rinj (15-30 vjeç) nëpërmjet 149 intervistave ballë për ballë me fëmijë dhe 197

intervistave ballë për ballë me prindërit e fëmijëve në moshë shkollore.

- E dyta u fokusua në përfshirjen në sistemin arsimor të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ekipi LYRA mblodhi informata mbi 205 fëmijë me nevoja të veçanta. Të anketuarit u përzgjedhën nga baza e të dhënave të dy OJQ-ve që merren me fëmijët me nevoja të veçanta, të cilat janë HandiKOS dhe One-to-One.
- Në Prizren, ku banojnë romë, ashkali dhe egjiptianë, ekipi LYRA vendosi të hulumtojë mbi dy çështje:
 - E para duke u përqendruar në braktisjen e shkollës nga ana e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë. Ekipi mblodhi informacion mbi 294 fëmijë romë, ashkali dhe egjiptianë në moshë shkollore përmes 139 intervistave ballë për ballë me fëmijët dhe 171 intervistave ballë për ballë me prindërit.
 - Çështja e dytë u përqendrua në martesat e hershme. Ekipi mblodhi informacion mbi 217 fëmijë romë, ashkali dhe egjiptianë në moshë shkollore përmes 109 intervistave ballë për ballë me fëmijët dhe 108 intervistave me prindërit.

Kufizimet e studimit

Liderët e rinj kishin pak qasje teorike të temave kërkimore mbi të cilat po hulumtonin. Kështu pra është e mundur që fenomenet e rëndësishme, sjelljet apo qëndrimet që janë të lidhura me çështjen e hulumtuar të mos jenë hulumtuar mirë, ose aspak. Caktimi i konsulentëve kombëtarë për të ndihmuar liderët e rinj me hulumtimet me pjesëmarrje mund të kenë shmangur në një farë mase këtë kufizim.

Komunitetet e cenueshme, të përjashtuara dhe të diskriminuara mund të ngurrojnë për t'iu përgjigjur sondazheve për disa arsye. Ata mund të kenë ndjenjën e mosbesimit në lidhje me temat e anketës apo njerëzit që e kryejnë atë. Ata ndoshta nuk mund të shohin një arsye për t'iu përgjigjur anketës dhe koha për t'iu përgjigjur pyetjeve të sondazhit mund t'iu duket e pavlefshme.

Njëanshmëria e dëshirës për t'u paraqitur nën një dritë të pëlqyeshme është një shqetësim për të gjitha të dhënat e sondazhit. Kjo lidhet me tendencën e të anketuarve për të raportuar qëndrime shoqërore dhe sjellje të dëshiruara. Me fjalë të tjera referuesit mund

të raportojnë atë çka mendojnë se anketuesi dëshiron të dëgjojë. Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të disa prej temave kërkimore ky mbetet një shqetësim i vërtetë.

Refuzimi është një shqetësim për të gjitha të dhënat e sondazhit, sepse individët mund të refuzojnë t'i përgjigjen një pyetje nëse mendojnë se një përgjigje e sinqertë mund t'i pasqyrojë negativisht. Me disa përjashtime, si rasti në një komunitet në Bosnjë-Hercegovinë, refuzimet ose nuk janë regjistruar apo përqindja e refuzimeve nuk është raportuar.

Marrja e kampioneve është një komponent i rëndësishëm i studimit që përcakton përgjithësim dhe siguri në rezultate. Vetëm ekipet kosovare LYRA kanë përdorur probabilitetin në marrjen e mostrave për të zbatuar projektet e tyre. Ekipet LYRA në Kosovë kryen hulumtimet e tyre mbi *braktisjen e shkollës* dhe *martesat e hershme* në Prizren dhe *diskriminim* nga mësuesit në Gjakovë duke përdorur marrjen e kampioneve sistematike të rastësishme. Ata intervistuan subjektet e tyre në çdo tre shtëpi në lagjet që hynin në temën e studimit. Këto rezultate mund të përdoren brenda kufizimeve të tyre për të nxjerrë konkluzione të përgjithshme në lidhje me çështjet e lartpërmendura për popullatën rome, ashkali dhe egjiptiane. Procedura ndryshoi në lidhje me temën “Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor”. Kjo nuk përbën një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse të fëmijëve me nevoja të veçanta, pasikampioni është përzgjedhur rastësisht nga baza e të dhënave të One-to-One dhe HandiKOS, të cilat ofrojnë shërbime për këta fëmijë në Gjakovë. Rezultatet nga ky studim mund të përgjithësohen vetëm për fëmijët me nevoja të veçanta që kanë qenë pjesë e organizatave të ngjashme me One-to-One dhe HandiKOS.

Ekipet LYRA në Shqipëri përdorën kampionimin e volitshëm. Kështu që rezultatet e nxjerra nga studimet e tyre nuk janë përgjithësuese. Megjithatë ato mund të përdoren si një pikënisje për fillimin e veprimit dhe kryerjen e hulumtimeve sistematike në të ardhmen për të përcaktuar më saktësisht probleme më të mëdha me të cilat përballet komuniteti rom dhe egjiptian, si dhe mënyrat më efektive dhe efikase për të trajtuar këto çështje.

Shumica e ekipeve kërkimore me pjesëmarrje anembanë vendeve ishin në rolin e intervistuesit për herë të parë, pra me një njohje të cekët të parimeve të intervistimit. Shumë prej tyre duke qenë pjesë e komunitetit të përfshirë në këtë studim mund të kenë krijuar njëanshmëri në lidhje me temat që hulumtonin. Të dyja këto fakte mund të kenë

dobësuar cilësinë e të dhënave, pasi të dhëna të njëanshme rezultojnë në konkluzione të njëanshme.

Projekti LYRA hulumtoi dhe veproi mbi një sërë pyetjesh të ngjashme kërkimore të tilla si braktisja e shkollës, përfshirja sociale dhe koha e lirë si dhe hartës sociale të komuniteteve rome. Megjithatë, krahasimi mes vendeve nuk është i mundur ekjo kryesisht për tri arsye. Së pari procesi kërkimor me pjesëmarrje është zbatuar ndryshe nga një vend në tjetrin. Së dyti teknikat e përdorura për të mbledhur informacionin nuk ishin të ngjashme në të tre vendet. Ekipet shqiptare përdorën fokus grupet, kampione të vogla të përshtatshme me pyetësorë të thjeshtë dhe intervista. Ekipet boshnjake dhe kosovare përdorën kryesisht sondazhet. Së treti dhe më i rëndësishmi ishte zhvillimi i instrumenteve në secilin vend, i bërë veç e veç dhe pa koordinim. Kjo rezultoi në instrumente dhe variablatë ndryshme, pra rrjedhimisht në të dhëna të pakrahasueshme.

Struktura e raportit

1. Raporti fillon duke përshkruar projektin LYRA: qëllimet, zbatimin, përfitimet dhe sfidat duke u përqendruar kryesisht në komponentin e kërkimit me pjesëmarrje. Vetë studimi fokusohet në tri tema: diskriminimi, përjashtimi social dhe arsimimi. Edhe pse këto tri tema diskutohen në kapituj të veçantë, ato janë thellësisht të ndërthurura, duke ndikuar dhe ndërvepruar me njëra-tjetrën. Për shembull, në Sarajevë, kryeqyteti i Bosnje-Hercegovinës, 40% e romëve të intervistuar nuk janë të regjistruar që në lindje në gjendjen civile apo pas mbërritjes në vend, kjo për shkak të mungesës së informacionit apo të shtetësisë së huaj, e si rezultat i kësaj gjendjeje ata nuk kanë dokumente identifikimi. Kjo situatë krijon një terren të favorshëm për diskriminim dhe i parandalon ata që të përfitojnë plotësisht nga mundësi të tilla si shkollimi dhe punësimi, që janë ndër parakushtet e pjesëmarrjes së plotë në jetën ekonomike, sociale dhe civile. Mungesa e arsimimit dhe punësimit thellon përjashtimin e tyre shoqëror, ndoshta për shkak të diskriminimit, mungesës së aftësive profesionale dhe varfërisë. Pra, romët tashmë gjenden në një rreth të mbyllur përjashtimi, diskriminimi dhe varfërie prej brezash. Kështu secili kapitull dhe pjesët përbërëse të tij duhet të lexohen si një komponent përbërës po aq i rëndësishëm i temës gjithëpërfshirëse të të drejtave të njeriut, si diçka e natyrshme për të gjitha qeniet njerëzore pavarësisht nga seksi, origjina apo bindjet.

- II. Kapitulli i dytë shqyrton përkufizimin e diskriminimit dhe rastet e hulumtuara që futen në këtë kategori. Fokusi kryesor i këtij kapitulli është mbi (1) identifikimin e diskriminimit ndaj popullsisë rome në shkollë apo nga politikat e mbledhjes së të dhënave; (2) perceptimin e vetë popullatës mbi diskriminimin; (3) dhe perceptimin e popullatës jo-rome lidhur me diskriminimin ndaj popullsisë rome.
- III. Kapitulli i tretë përqendrohet në përkufizimin e përjashtimit social dhe në rastet e përjashtimit social në secilin kontekst të vendit. Analiza e përjashtimit social bazohet mbi faktorët ekonomikë, politikë, të identitetit, aftësive dhe atyre gjinore. Progresi nga një bazë e përjashtimit social në një tjetër përforcon argumentin se shkaqet kryesore të këtij fenomeni janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin.
- IV. Kapitulli i katërt trajton çështjen e edukimit të popullsisë rome. Përshkruan një realitet të zymtë, ku popullata rome është më pak e arsimuar në raport me të gjitha grupet etnike përbërëse, me një përqindje të lartë të braktisjes së shkollës dhe interes të pamjaftueshëm për të çuar përpara arsimimin e fëmijëve.
- V. Kapitulli i pestë mbështet fuqizimin e të rinjve romë duke paraqitur raste suksesi programatike dhe individuale në të tre vendet. Në Shqipëri, ekipi LYRA në Roskovec mbrojti me sukses projektin dhe mori një hapësirë për të krijuar një qendër rinore, ku të rinjtë romë dhe jo romë mund të veprojnë e të shkëmbejnë së bashku; ndërsa Kristi nga Korça është bërë një lider për ndryshimin e marrëdhënieve midis romëve dhe jo romëve. Në Bosnjë-Hercegovinë programi LYRA zbatoi me sukses një komponent të praktikës në punë, në të cilin 10 të rinj romë përfunduan një stazh praktik në organizata të ndryshme, dhe Ramizi, njëri prej tyre u dallua për punën e tij. Në Kosovë, Fatlumi u bë një katalizator për rritjen e ndërveprimit në mes të komuniteteve jo romë dhe romë të Prizrenit.
- VI. Dy kapitujt e fundit parashirojnë përfundimet dhe rekomandimet. Kapitulli mbi rekomandimet përbëhet nga dy seksione. Një pjesë paraqet rekomandimet e politikave. Pjesa tjetër në formë lakonike paraqet planet e veprimit për advokim në nivel rajonal, të hartuar nga ekipet LYRA gjatë një procesi bashkëpunues.

PROJEKTI: KOMPONENTI KËRKIMOR ME PJESËMARRJE

Projekti LYRA ka për qëllim **të fuqizojë dhe të zhvillojë kapacitetet dhe kompetencat** e liderëve të rinj romë dhe jo romë në Shqipëri, Kosovë dhe Bosnje-Hercegovinë. Ky projekt i ndihmoi pjesëmarrësit LYRA për të identifikuar diskriminimin dhe përjashtimin social, si çështje me rëndësi të përbashkët për romët në të gjithë rajonin dhe të propozojnë mesazhe advokuese rajonale të zbatueshme, si dhe zgjidhje për të adresuar në mënyrë efektive këto çështje.

Projekti LYRA nisi më **26 mars 2013**. Organizatat Roma Active Albania (RAA) dhe Iniciativa 6 në Kosovë ishin partnerët implementues në këto dy vende, ndërsa në Bosnje-Hercegovinë nuk u përzgjedh asnjë partner për të shmangur ndarjet etnike, të cilat pasqyrohen edhe në organizatat rome që punojnë në atë vend.

Save the Children trajnoi **60 liderë të rinj romë e jo romë** lidhur me metodologjinë, zbatimin dhe etikën e kryerjes së hulumtimeve me pjesëmarrje. Liderët e rinj të trajnuar, trajnuan më tej 126 romë dhe jo romë. Ata u ndanë në 14 ekupe hulumtimi dhe u angazhuan në komunitetet rome, por edhe në komunitete të tjera, për të kuptuar se cilat ishin temat kërkimore që shqetësonin më tepër këto komunitete. Pas përcaktimit të temave, ekipet kërkimore me ndihmën e Save the Children, RAA dhe Iniciativa 6 identifikuan grupet e aktorëve që do të intervistoheshin në komunitetet e synuara. Për secilin grup aktorësh ata zhvilluan instrumentet e nevojshme dhe mblodhën të dhënat mbi 14 tema kërkimore. Çdo ekip i organizoi dhe analizoi të dhënat, falë të cilave ata krijuan një raport ku përshkruan procesin e hulumtimit, gjetjet dhe veprimet e mundshme për të korrigjuar problemet e identifikuara nga hulumtimi.

Në fund të fazës së hulumtimit liderët e rinj romë dhe jo romë zhvilluan një advokim lokal për të adresuar problemet që ata kishin identifikuar dhe hulumtuar në komunitetet e tyre. Përveç planeve të veprimit, ekipet LYRA u përfshinë në advokim përmes pjesëmarrjes së tyre në mbledhje kombëtare rajonale dhe ndërkombëtare, ku ata paraqiten punën e tyre, shqetësimet dhe zgjidhjet në lidhje me problematikat me të cilat përballen komunitetet rome në këto tre vende.

Përdorimi i hulumtimit me pjesëmarrje i pajisi ekipet LYRA me njohuritë bazë mbi logjikën dhe procedurat kërkimore. Arritjet më të mëdha për liderët e rinj ishin ndërgjegjësimi në lidhje me aftësinë e tyre për të vepruar, për të adresuar problemet dhe për të përmirësuar jetën e tyre, mbledhja e informacionit, mënyra e dallimit të problemeve të përjashtimit social dhe diskriminimit, puna në ekip dhe aftësia udhëheqëse, aftësitë komunikuese dhe ato të adokimit për të ekzekutuar veprimet e tyre të mundshme dhe, në disa raste, advokiminë jetën e përditshme. Në fund të projektit 186 të rinj romë dhe jo romë ndiheshin më të përgatitur se kurrë për të marrë jetën e tyre në dorë dhe të pajisur me mjetet e duhura për të qenë të dobishëm për veten dhe komunitetin e tyre.

Save the Children në Shqipëri, RAA, Iniciativa 6 dhe liderët e rinj u ballafaquan me shumë sfida. Mirëpo në vend që të shkuraoheshin, të gjithë aktorët i përdorën këto sfida për zhvillimin e aftësive të tyre organizative dhe personale. Edhe pse grupi teorik i të rinjve romë të angazhuar me gjasë në projektin LYRA mund të ishte mjaft i gjerë për shkak se popullata rome është më e re se grupet me identitete të tjera etnike, grupi aktual nga të cilët u zgjodhën pjesëmarrësit LYRA, ishte më i vogël. Arsyet kryesore për këtë janë se ashtu si në vendet e tjera të Europës Lindore, në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë popullsia rome është e paangazhuar në shoqëri dhe ka nivel arsimor tejet të ulët; ajo jeton në varfëri të skajshme dhe, në disa raste, romët kanë vështirësi në paraqitjen e dokumenteve të identitetit apo pasaportave. Megjithatë, në mënyrë që të sigurohej pjesëmarrja e të rinjve romë në këtë projekt, Save the Children dhe partnerët e saj ndihmuan disa të rinj për të marrë dokumentet e identifikimit apo pasaporta dhe kushtëzuan pjesëmarrjen e disa të tjerëve në projekt me vazhdimin e arsimit ose diplomimin nga shkolla fillore apo ajo e mesme. Sipas këtij kushti, në Bosnje-Hercegovinë tre të rinj romë përfunduar arsimimin e tyre fillor dhe dy të tjerë janë duke ndjekur shkollën e mesme.⁷

DISKRIMINIMI NDAJ TË RINJVE ROMË DHE FËMIJËVE TË TJERË JO-ROMË

Në këtë raport, **diskriminimi** është përkufizuar si “*diferencim negativ në trajtimin e një individi apo një grupi, bazuar në elementë të caktuar si seksi, origjina, apo opinionet⁸, e që ka për qëllim ose ndikon negativisht tek dikush për të gëzuar plotësisht të drejtat e tij.*”

Diskriminimi mund të jetë i ligjshëm, institucional, shoqëror apo individual.

Diskriminimi ligjor ekziston kur ka diferencim negativ të një grupi në ligjet e vendit. Diskriminimi institucional ekziston kur miratohen politika institucionale që dallojnë negativisht individë të grupeve të ndryshme. Diskriminimi shoqëror ndodh kur grupet në shoqëri dallojnë negativisht individë apo grupe të tjera po në atë shoqëri, si rezultat i paragjytimeve që ata mbartin në lidhje me grupin e diskriminuar. Diskriminimi individual ndodh kur individë të veçantë dallojnë negativisht individë të grupeve të tjera për shkak të paragjytimeve personale. Si një nga mekanizmat kryesore që sjell përjashtimin social të individëve dhe të grupeve, ekipet kërkimore me pjesëmarrje LYRA hulumtuan me kujdes diskriminimin gjatë punës në fushat e edukimit, informimit, dhe disponueshmërisë të të dhënave.

Hulumtimi me pjesëmarrje në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë nuk ka gjetur asnjë bazë për diskriminim ligjor në këto tre vende në temat që ata kanë hulumtuar. Ligjet dhe aktet nënligjore garantojnë trajtim të barabartë dhe mundësi për të gjithë qytetarët. Në përgjithësi, institucionet e hulumtuara, si për shembull shkollat, kanë politika të tilla që sigurojnë një trajtim të barabartë apo promovojnë diferencimin pozitiv të të rinjve romë. Qëndrimet, sjellja diskriminuese dhe përjashtuese e popullsisë jo-rome nuk janë

hulumtuar në mënyrë sistematike. Mjaft hulumtime dëshmojnë qëndrime diskriminuese, përjashtuese dhe sjellje ndaj popullatës romë, jo vetëm në këto tre vende, por edhe në Ballkanin Perëndimor dhe në të gjithë Europën. Hulumtimi me pjesëmarrje konstatoi ekzistencën e boshllëqeve në ligje, rregulla, politika, si dhe në zbatimin e tyre. Institucionet publike në mënyrë indirekte përjetësojnë veprimet diskriminuese dhe përjashtuese, kur punonjësit e sektorit publik në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pavetëdijshme, haptazi apo në mënyrë indirekte, shfaqin qëndrime dhe sjellje diskriminuese gjatë kryerjes së detyrës publike. Kështu, baza ligjore, institucionale dhe politike me pjesëmarrje jo-diskriminuese njollosen dhe nganjëherë deformohen rëndë nga qëndrimet dhe sjelljet diskriminuese dhe përjashtuese të individëve që punojnë në institucionet publike.

Diskriminimi, qoftë direkt apo indirekt, mund të bëhet pa u vënë re nga ana e viktimave, autorëve apo vëzhguesve. Mjediset në të cilat qëndrimet diskriminuese dhe sjelljet kundër një grupi janë pranuar si normale për shkak të rrënjëve të thella historike, do të vazhdojnë të përjetësojnë diskriminimin pavarësisht nga ligjet apo politikat ekzistuese. Viktimat e diskriminimit duke mos njohur asnjë trajtim tjetër përveç diskriminimit do ta pranojnë këtë situatë si normale. Disa autorë apo vëzhgues të diskriminimit janë të vetëdijshëm se diskriminimi ndaj njerëzve të një grupi të caktuar po ndodh; por ka edhe të tjerë që nuk janë të vetëdijshëm se veprimet e tyre janë diskriminuese apo se ata janë duke vëzhguar një rast diskriminimi, për të njëjtën arsye edhe viktimat e diskriminimit nuk mendojnë se janë të tilla.

Ekipi LYRA në Banja Luka, në Bosnje-Hercegovinë konstatoi se 87% e të intervistuarve romë nuk mendojnë se janë viktimat e diskriminimit, ndërsa 47% e të intervistuarve jo-romë pohon se romët janë të diskriminuar. Pyetje të mëtejshme zbuluan se shumë nga romët e intervistuar nuk dinë se si ta përkufizojnë diskriminimin. Megjithatë, shumë të anketuar romë pohuan se ata nuk ishin të diskriminuar edhe pas sqarimeve në lidhje me përkufizimin e diskriminimit.

Mungesa e të dhënave dhe diskriminimi

Të dhënat dhe statistikat e besueshme janë parakusht për të identifikuar, kuptuar, analizuar dhe adresuar problemet në çdo shoqëri dhe në çdo aspekt të jetës njerëzore. Në mungesë të të dhënave dhe statistikave të besueshme çdo hap i identifikuar më

lart, me shumë gjasa, do të ishte i paplotë dhe i ndërtuar keq. Mungesa e të dhënave dhe statistikave të besueshme në vendet me burime të pamjaftueshme publike dhe /ose private mund të përdoret si justifikim për të mos njohur praninë e problemeve ekzistuese, për të fshehur problemet apo si justifikim për mosveprimi, veprim të pamjaftueshëm për të adresuar këto probleme nga qeveria e atij vendi. Mungesa e të dhënave dhe statistikave të tilla mund të bëhet një pengesë për marrjen e fondeve në dispozicion e të nevojshme për trajtimin e problemeve të tilla. Dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, kjo mund të dobësojë më tej apo shkurajojë grupet e cenushme siç janë romët dhe fëmijët me nevoja të veçanta për të filluar ose vazhduar punën për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

Ekipet LYRA, në të tre vendet pjesëmarrëse, Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, u përballën me mungesën e të dhënave apo të paplota në lidhje me çdo çështje që ata kanë hulumtuar. Ata konstatuan se të dhënat e disponueshme janë të pakta dhe nganjëherë të pasakta. Pothuajse të gjitha vendet në zhvillim kanë mangësi në të dhënat e tyre në lidhje me fëmijët me nevoja të veçanta. Ekipi LYRA në Gjakovë, Kosovë, konstatoi se kjo është e vërtetë edhe për Kosovën. Aktualisht, në Kosovë nuk ka të dhëna zyrtare për të përafuar numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta.¹⁰ Për më tepër, të dhënat për popullsinë rome në Kosovë janë të paplota, sepse skaji verior i Kosovës, ku jetojnë shumë romë, nuk morën pjesë në regjistrimin e vitit 2011. Ekipet LYRA në Bosnje-Hercegovinë krijuan një hartë sociale dhe ekonomike të disa vendbanimeve rome, pikërisht për shkak të mungesës të të dhënave për këto komunitete. Në Shqipëri, ka të dhëna të mbledhura nga regjistrimi i vitit 2011, por këto të dhëna janë kontestuar si të pasakta nga shoqatat rome.

Mungesa e ndërgjegjësimit të popullatës rome rreth rëndësisë së regjistrimit, të tilla si regjistrimi i lindjeve dhe martesave mund të shndërrohet në burim të mungesës së të dhënave. Për shembull, të dhënat nga anketa mbi martesat e hershme në Prizren, Kosovë, tregojnë se 91.7% e të rinjve romë deklaruan se ata nuk e kanë regjistruar martesën e tyre në komunë në momentin e martesës dhe 40.7% e tyre e kanë regjistruar martesën e tyre më pas. Fakti që shumica e martesave të hershme mbeten të paregjistruar në regjistrin civil e bën këtë fenomen të padukshëm ndaj zyrtarëve, politikë bërësve dhe aktorëve të tjerë. Kështu që, programe që rrisin ndërgjegjësimin e popullatës rome lidhur me rëndësinë e regjistrimit zyrtar dhe marrjen e masave për të lehtësuar regjistrime të tilla si lindjet dhe martesat mund të ndihmojnë në adresimin e mungesës së të dhënave.

Diskriminimi nga mësuesit dhe në shkolla

Diskriminimi ndaj të rinjve romë nga mësuesit mund të manifestohet në mënyra të ndryshme. Fëmijët romë mund të ndahen brenda një klase apo shkolle; mësuesit nuk iu kushtojnë të njëjtën vëmendje si fëmijëve të tjerë jo-romë ose thjesht i injorojnë ata; mësuesit nuk kontrollojnë detyrat e shtëpisë së fëmijëve romë; ose ata nuk u sigurojnë të njëjtën ndihmë shtesë siç bëjnë me fëmijët jo-romë.

Në mungesë të ndonjë studimi apo raporti të detajuar mbi diskriminimin e fëmijëve romë nga mësuesit e tyre dhe në prani të perceptimit të përhapur gjerësisht se fëmijët romë janë të diskriminuar nga mësuesit e tyre, ekipi LYRA në Gjakovë, Kosovë hulumtoi mbizotërimin e diskriminimit të fëmijëve romë në sistemin shkollor dhe konstatoi se një diskriminim i tillë ndodh realisht. Në secilën prej 19 shkollave që u anketua, kishte prova ndarjeje të shkollave dhe të klasave. Të gjithë të intervistuarit ndiqnin shkolla dhe klasa të rregullta. Ndarja e shkollës mund të jetë një rezultat i popullsisë rome duke u përqendruar në lagjet e veçanta, kështu që shumica e fëmijëve romë shkojnë në shkolla që janë të vendosura në afërsi të lagjeve të tyre. Megjithatë, ka edhe elementë të ndarjes brenda klasave. Rreth 75% e të anketuarve romë deklaruan se edhe pse ata janë në klasa kryesisht me fëmijët jo romë, pothuajse 60% e fëmijëve romë ndajnë bankën me fëmijë të të njëjtit identitetit etnik, ndërsa 90% prej tyre shoqërohen me fëmijët e të njëjtit identitetit etnik gjatë pushimeve në shkollë ose pas orëve të mësimi.

Ekipi LYRA në Pogradec, Shqipëri, hulumtoi rastin e një shkolle diskriminuese. Banorët e Pogradecit, e kanë zakon të quajnë Shkollën Kozma Gjok Basho, shkolla rome 9-vjeçare, edhe pse vetëm 10% e nxënësve është me prejardhje rome. Për më tepër, kjo shkollë nuk është e mirëmbajtur dhe pajisjet janë larg nga të qenit të pranueshëm për një institucion arsimor. Prindërit gjithashtu heqin fëmijët e tyre nga kjo shkollë dhe i regjistrojnë në shkolla të tjera. Etiketa e saj si shkollë romë dhe heqja e fëmijëve jo-romë nga kjo shkollë e bën komunitetin rom të ndjehet i diskriminuar.

Fokus grupet dhe intervistat e kryera me aktorë të ndryshëm sugjerojnë se Shkolla Kozma Gjok Basho është etiketuar si një shkollë rome për shkak të pozicionit të saj gjeografik, p.sh. në periferi të qytetit dhe në afërsi të një lagje mbizotëruar nga romët, e gjithashtu është e lënë pas dore si shkollë. Fokus grupet dhe një studim me 20 nxënës romë dhe

jo-romë në këtë shkollë nxori në pah se diskriminimi ndaj fëmijëve romë nuk mund të jetë një problem. Nxënësit thonë se kanë marrëdhënie shumë të mira me mësuesit dhe se ata rrallë dallojnë nxënësit në bazë të identitetit të tyre etnik. Ata mendojnë se në përgjithësi të drejtat e tyre respektohen. Rezultatet e një studimi të kryer me prindërit e nxënësve mbështet deklaratat se marrëdhëniet mësues-nxënës janë pozitive dhe nuk ka diskriminim me bazë gjinore. Megjithatë, pyetësorët me fëmijët që kanë lënë Shkollën Kozma Gjok Basho nxjerrin në pah se jo vetëm kushtet e këqija të objekteve shkollore, por edhe mësimi me cilësi të ulët dhe mosmarrëveshjet me mësuesit dhe nxënësit i kanë shtyrë ata të transferohen në shkolla të tjera. Përfaqësues të Departamentit të Arsimit në Pogradec e konsiderojnë gjendjen e keqe infrastrukturore në Shkollën Kozma Gjok Basho si rezultat i mungesës së burimeve e jo i diskriminimit.

Nëse një infrastrukturë e keqe, një mësimdhënie me cilësi të ulët dhe marrëdhënie të vështira mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës për ata që ikin nga kjo shkollë, janë tregues të diskriminimit kundër popullsisë rome, kjo mund të përcaktohet vetëm nga hulumtimet sistematike. Megjithatë, intervistat nxorën në pah se banorët në qytetin e Pogradecit i lidhin romët me nocionin e varfërisë, shërbimeve me cilësi të ulët dhe marrëdhënieve konfliktuale. Është pikërisht ky perceptim për popullatën rome që që me shumë gjasa, ka përjetësuar etiketimin e Shkollës Kozma Gjok Basho si një shkollë rome edhe pse vetëm 10% e nxënësve janë romë.

PËRJASHTIMI SOCIAL I TË RINJVE ROMË

Nuk ka asnjë raport ku të mos konstatohet se të rinjtë romë, egjiptianë dhe ashkali në të gjithë Europën Juglindore dhe Lindore janë të përjashtuar nga shoqëria. Ky raport përforcon këto pretendime dhe përshkruan me të dhëna sasiore dhe cilësore që këto grupe janë me të vërtetë të shoqërisht përjashtuara në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Analiza e përjashtimit social këtu është bazuar në përkufizimin e Komisionit Europian të përjashtimit social, kur njerëzit pengohen nga pjesëmarrja e plotë në jetën ekonomike sociale dhe civile dhe/ose kur qasja e tyre në të ardhura dhe burime të tjera (personale, familjare, sociale dhe kulturore) është aq e pamjaftueshëm sa t'i përjashtojë ata nga gëzimi i një standardi dhe cilësie jetese që konsiderohet si e pranueshme nga shoqëria në të cilën jetojnë. Në situata të tilla njerëzit nuk janë në gjendje të kërkojnë plotësisht të drejtat e tyre themelore.”¹¹

Përjashtimi social shihet si një koncept shumëdimensional, çdo dimension i së cilit përforcon të tjerët. **Dimensionet e përjashtimit social, elementet e të cilit janë identifikuar dhe hulumtuar nga ekipet LYRA në të tre vendet, futen në kategoritë e mëposhtme: ekonomike dhe politike, identiteti dhe qytetaria, gjinia dhe aftësia.** Përjashtimi social është konstatuar kryesisht në nivel individual dhe në nëngrup.

Dimensioni ekonomik i përjashtimit social

Dimensioni ekonomik i përjashtimit social ka një lidhje të qartë me varfërinë dhe rrjedhojat e saj që janë statusi në tregun e punës, arsimimi, gjinia dhe migrimi, të cilat, veçmas apo të kombinuara, i përballin popullatat rome, ashkali dhe egjiptiane me një gjendje privimi që

nuk i lejon ata të marrin pjesë në shoqëri dhe të gëzojnë plotësisht standardet e pranueshme të jetesës. Jeta në kulmin e varfërisë dhe me pak mundësi punësimi për të nxjerrë veten nga varfëria, i detyron romët të bëjnë shpesh zgjedhje jo të qëllimshme që kanë rezultate përkeqësuese të standardeve të jetesës aktuale dhe për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Varfëria dhe papunësia janë theksuar si përcaktues të rëndësishëm në përqindjen e lartë të braktisjes shkollore, martesave të hershme, veçanërisht tek vajzat e reja, si dhe mos qasjes ndaj shërbimeve që janë në dispozicion por që mbeten të pashfrytëzuara nga të rinjtë romë.





Tabela 3.1. Një paraqitje skematike e ndërlidhjes mes varfërisë dhe papunësisë, braktisjes, martesave të hershme dhe qasjes ndaj shërbimeve

Të dhënat nga projekti LYRA në Bosnje-Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri sugjerojnë se varfëria dhe papunësia janë të përhapura në komunitetet rome. Në Banja Luka, Mostar dhe Tuzla në Bosnje-Hercegovinë përqindja e atyre që kanë një punë të qëndrueshme e të deklaruar shkon nga 0,15 në 11%. Pjesa tjetër e romëve ose punojnë si punëtorë me mëditje ose në ekonominë gri apo nuk janë aspak pjesë e fuqisë punëtore. Varfëria dhe papunësia ishin ndër çështjet kryesore të identifikuar në Shqipëri në qytetin e Korçës dhe komunat e Baltëzës dhe Levanit, ndërsa në Kosovë, në komunat e Prizrenit dhe Gjakovës.

Në Bijeljinës, Bosnje- Hercegovinë, 48 nga 50 të anketuarit romë u shprehën se është e rëndësishme që fëmijët e tyre të qëndrojnë në shkollë edhe pas shkollës së mesme. Megjithatë, kjo preferencë duket qartë se është e varur nga situata financiare e familjes.

Tridhjetë e katër prej 50 të anketuarve kanë deklaruar se ata nuk do të jenë në gjendje t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë pasi ka mungesë të ndihmave me libra dhe mjete shkollore. Në Levan, Shqipëri, një e treta e të intervistuarve deklaruan se 30 të rinj romë kanë braktisur shkollën për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Në Prizren 52% nga 48 të intervistuarve në moshë shkollore janë përgjigjur se kanë braktisur shkollën për arsye të vështirësive financiare, si një arsye kryesore për braktisjen e shkollës, ndërsa 35 të anketuarit në moshë shkollore që aktualisht ndjekin shkollën nuk do të mund të vazhdojnë arsimimin e tyre për shkak të kushteve të këqija financiare, 16% sepse duhet të punojnë dhe 19% sepse duhet të kujdesen për vëllezërit e motrat e tyre. Nëntëdhjetë e tre për qind (93%) e prindërve të intervistuar me fëmijë me nevoja të veçanta në Gjakovë, Kosovë kanë deklaruar se ata do t'i dërgonin fëmijët e tyre në shkollë, nëse do të kishin kushte më të mira financiare.

Në Prizren, Kosovë, faktori ekonomik mund të ketë një efekt mbi martesat e hershme. Më pak se 3% nga 109 të rinjtë romë, egjiptianë dhe ashkali të intervistuar pranojnë se situata e vështirë financiare ka ndikuar në vendimin e tyre për t'u martuar. Kur u pyetën në përgjithësi në lidhje me martesat e hershme 22% pranuan se një situatë e vështirë financiare është një ndër faktorët kryesorë që shtyn drejt lidhjes martesore. Është e kuptueshme që të anketuarit do të ngurrojnë të pranojnë se vështirësitë financiare i kanë



shtyrë ata drejt martesës për shkak se mund të duket sikur ata cenojnë idenë që njerëzit martohen sepse duhen. Por kur u jepet mundësia të distancojnë veten nga fenomeni dhe u bëhet pyetja në lidhje me arsyet e një martese të hershme në përgjithësi ata kanë tendencë të zgjedhin gjendjen e vështirë financiare më shpesh se çdo arsye tjetër.

Identiteti, dokumentet e identitetit dhe përjashtimi social

Identiteti etnik është një bazë për përjashtimin social nga të tjerët, por edhe për vetë përjashtim. Identiteti etnik është i lidhur me tipare sociale kulturore dhe organizative që dallojnë një grup etnik nga një tjetër. Këto dallime janë një bazë për krijimin e stereotipave etnike të cilat shërbejnë si themel për paragjytime, sjellje diskriminuese dhe përjashtuese nga grupet e tjera etnike. Në përgjithësi pakicat kanë më shumë gjasa të përjetojnë efekte negative në jetën e tyre, si rezultat i këtyre paragjykimeve. Një shembull i përjashtimit social të romëve për shkak të identitetit të tyre etnik u hulumtua nga ekipet LYRA në Shqipëri dhe Bosnje-Hercegovinë.

Shkolla nëntë vjeçare Kozma Gjok Basho ndodhet në Pogradec, një qytet me 40.138 banorë. Nga 40 fëmijë romë, të cilët ndjekin arsimin bazë në këtë qytet, 18 prej tyre janë në shkollën Kozma Gjok Basho. Ata përbëjnë 10% të nxënësve të kësaj shkolle. Shkolla Kozma Gjok Basho është etiketuar si një shkollë rome dhe nuk përfiton nga fondet e nevojshme. Ekipi LYRA konstatoi se nuk ka pasur asnjë investim në 40 vitet e fundit në shkollën nëntë vjeçare, ndërkohë që ka pasur investime në shkollat e tjera nëntë vjeçare të Pogradecit. Si rrjedhojë, prindërit i kanë hequr fëmijët e tyre nga kjo shkollë dhe i kanë regjistruar në shkolla të tjera. Identiteti etnik dhe karakteristikat demografike të fëmijëve që frekuentojnë këtë shkollë mund të jenë arsyet për mosveprim nga ana e autoriteteve të arsimit dhe paragjykimeve ekzistuese në mesin e popullsisë jo rome. Megjithatë, hulumtimet sistematike do të kishin qenë një mjet shumë efektiv për të zbuluar realitetin që fshihet prapa kësaj shkolle, e cila nuk merr fondet e nevojshme dhe është lënë pas dore.

Përjashtimi social i një pjese të të rinjve romë në Sarajevë ndodh për shkak të shtetësisë dhe dokumenteve të identitetit. Ekipi LYRA konstatoi se nga 50 të rinjtë romë të intervistuar 16 nuk figuronin në regjistrin e gjendjes civile për shkak të kombësisë së huaj ose mungesës së informacionit, 26 nuk kanë sigurim shëndetësor kryesisht për shkak të shtetësisë së huaj të prindërve të tyre, ndërsa disa kanë vështirësi regjistrimi në shkollë. Në mungesë të

një certifikatë lindjeje ose kartës së identitetit për këta fëmijë është e vështirë për t'u regjistruar në shkollë dhe në disa raste ata janë ligjërisht të padukshëm. Hulumtimi, mbi pjesëmarrjen e romëve në shkolla, seksione dhe klube, i kryer në II zona të ndryshme nxori në pah se vetëm një shkollë ka krijuar një fond shtesë për të regjistruar fëmijët pa certifikatë lindje apo numër identifikimi personal. Stafi i kësaj shkolle i ndihmon prindërit dhe fëmijët për të marrë dokumentet sipas udhëzimeve të ministrisë.

Baza politike për përjashtimin social

Përjashtimi politik është një tjetër formë e përjashtimit social. Shoqëritë demokratike që funksionojnë jo vetëm që të krijojnë mekanizma për grupet e marginalizuara për të kanalizuar preferencat e tyre politike, por edhe i inkurajojnë ata për të përdorur këto mekanizma përmes fushatave të vazhdueshme informative e sensibilizuese. Madje partitë politike dhe grupet e interesit garojnë për mbështetjen e të gjitha grupeve, duke përfshirë ato që kanë një zë të dobët politik. Megjithatë, në mungesë të një demokracie që funksionon mirë dhe në praninë e diskriminimit kulturor dhe shoqëror ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane nga ana e shumicës, të rinjtë romë dhe egjiptianë nuk janë të përfshirë në pushtetin vendor.¹² Pjesëmarrja Hulumtim me pjesëmarrje në qytetin e Korçës, Shqipëri, konstatoi se 54 për qind e të anketuarve perceptonte se të gjithë të rinjtë ishin të pa përfshirë në pushtetin vendor. 59 për qind e të anketuarve perceptonte të rinjtë romë si të pa përfshirë në pushtetin vendor. Probabiliteti i kampionimit të volitshëm sugjeron se këto statistika mund të mos pasqyrojnë saktësisht opinionin e popullsisë mbi këtë temë. Intervistat e kryera me kryetarin e bashkisë së Korçës, dhe Rektorin e Universitetit nxjerrin në pah se nuk ka pasur përpjekje të mjaftueshme për të përfshirë të rinjtë në pushtetin vendor. Iniciativat për të informuar të rinjtë në lidhje me aktivitetet dhe ngjarjet që ndodhin në komunitetin e tyre kanë munguar. Megjithatë të intervistuarit theksojnë se komunitetet rome dhe egjiptiane nuk janë të organizuar për të paraqitur problemet e përbashkëta si grup. Ata prezantojnë vetëm probleme që janë të zakonshme në komunitetin e tyre në mënyrë individuale. Këto komente sugjerojnë se mbetet ende shumë për të bërë për të krijuar ose forcuar organizatat e komunitetit rom dhe egjiptian për të qenë të aftë të paraqesin dhe mbrojtur publikisht shqetësimet e tyre.

Aftësia dhe përjashtimi social

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve pranon se shkalla e aftësisë në të cilën ndodhet një fëmijë mund të bëhet arsye serioze për përjashtim social dhe diskriminim. Neni 23 veçon fëmijët me aftësi të kufizuara dhe detyron palët nënshkruese për të kushtuar kujdes të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara për të siguruar dinjitetin, vetëbesimin dhe të lehtësojë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në komunitet.¹³ Ekipi LYRA në Gjakovë, Kosovë, hulumtoi mbi fëmijët me nevoja të veçanta dhe integrimin e tyre në arsimin gjithëpërfshirës. Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Përfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Para Universitetin në Kosovë (2010-2015)¹⁴ dhe Plani Strategjik i Arsimit Kombëtar të Kosovës (2011-2016)¹⁵ tregojnë qartë se identifikimi dhe ndërhyrja për të rritur përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta ka hyrë në agjendën e qeverisë kosovare. Si pjesë e këtyre planeve 300 mësuesit e arsimit fillor janë trajnuar me metodat e reja të mësimdhënies për fëmijët me nevoja të veçanta dhe disa shkolla kanë filluar të përmirësojnë infrastrukturën e tyre për të bërë mundur arsimin gjithëpërfshirës. Këto shkolla më vonë do të përdoren si modele për shkollat ekzistuese që do të kalojnë në shkolla të arsimit gjithëpërfshirës, ku fëmijët me nevoja të veçanta dhe ata pa nevoja të tilla do të jenë në të njëjtat klasa. Fakulteti i Arsimit të Lartë kërkon që studentët të marrin kurse mbi arsimin gjithëpërfshirës në nivelin universitar dhe pasuniversitar¹⁶. Me iniciativën e Save the Children gjatë vitit 2013 Fakulteti i Edukimit ka filluar bashkëpunimin me Universitetin e Bolonjës në Itali për të vlerësuar dhe të rishikojë kurrikulat për arsimin gjithëpërfshirës dhe për të krijuar një program Master Degree për arsimin përfshirës.¹⁷ Save the Children ka ofruar ndihmë edhe për institucionet publike dhe jo publike lokale për të përmirësuar gjendjen e fëmijëve me nevoja të veçanta. Megjithatë, situata aktuale e fëmijëve me nevoja të veçanta në mjediset arsimore kërkon vëmendje më të madhe dhe punë në të gjitha nivelet: kombëtare, lokale institucionale dhe familjare.

Të dhënat në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin shkollor janë të bazuara vetëm mbi të dhënat të HandiKOS¹⁸ dhe të One-to-One në Gjakovë. Ekipi LYRA intervistoi prindërit e 205 fëmijëve me nevoja të veçanta të moshës 2 deri 20 vjeç dhe gjashtë shkollat fillore ku këta fëmijë ishin të regjistruar. Pothuajse gjysma (47%) e fëmijëve të anketuar kanë një paaftësi fizike, por më pak se 50% prej tyre kanë një pajisje ortopedike apo karrocë me rrota. Vetëm tri nga shkollat e anketuara kanë akses horizontal (fëmijë kanë qasje fizike në klasa dhe në objektet e tjera në katin e parë) dhe vetëm një

shkollë ka qasje vertikale për fëmijët me nevoja të veçanta fizike (fëmijë kanë qasje në katet e tjera). Pjesa tjetër e fëmijëve me nevoja të veçanta, për të cilat janë grumbulluar të dhënat, kishte aftësi të kufizuara si në vijim: 24% kanë disa aftësi të kufizuara mendore, 10% kanë dëmtim vizual, 9% me Sindromën Doun, 7% kanë probleme në të folur dhe 3% janë autikë. Një e treta e fëmijëve me nevoja të veçanta për të cilët janë grumbulluar të dhëna nuk shkojnë në shkollë. Përveç arsyeve financiare, mungesa e asistencës personale (48 për qind), mospranimi nga ana e shkollës (25 për qind), mungesa e infrastrukturave (8 për qind) dhe mungesa e teksteve (8 për qind) janë arsyt kryesore që fëmijët me nevoja të veçanta nuk ndjekin shkollën.

Ekipi LYRA në Gjakovë ka konstatuar se fëmijët me nevoja të veçanta fizike ose mendore kanë edhe pengesa tjera për të qenë të përfshirë. Ata janë të përjashtuar nga arsimi për shkak të varfërisë, të mungesës së infrastrukturave, të personelit të trajnuar dhe mentaliteteve. Një përjashtim i tillë qoftë strukturor, kulturor ose social parandalon fëmijët me nevoja të veçanta për të marrë pjesë plotësisht në jetën civile, ekonomike, sociale dhe akademike. Në situata të tilla fëmijëve me nevoja të veçanta u është mohuar mundësia për të gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore.

Gjinia dhe përjashtimi social

Ekipet LYRA identifikuan dy mënyra ku gjinia përbën themelin e përjashtimit social. Një mënyrë është martesë e hershme, si një fenomen që kryesisht ndikon tek vajzat. Një tjetër mënyrë ku gjinia shërben si një bazë për përjashtim social është frekuentimi i shkollës. Në disa komunitete vajzat ndjekin më pak shkollën në krahasim me djemtë.

Martesat e hershme¹⁹ janë një fenomen i pranishëm në shoqërinë kosovare, posaçërisht në gjirin e komuniteteve romë²⁰ edhe pse Ligji për Familjen i Republikës së Kosovës thekson në mënyrë të qartë se një person mund të martohet ligjërisht vetëm me arritjen e moshës madhore (18 vjeç), dhe se një martesë mes një 16 dhe 18 vjeçari mund të jetë e ligjshme vetëm nëse miratohet nga një gjyqtar pas një vlerësimi të pjekurisë fizike dhe fiziologjike të të miturve dhe pasi të ketë dëgjuar mendimet e kujdestarëve të tyre.²¹ Martesa e hershme është e lidhur ngushtë me çështjet gjinore, sepse ky fenomen është më i përhapur tek vajzat se sa tek djemtë. Në përgjithësi, martesat e hershme pengojnë vajzat e reja për të arritur potencialet e tyre të plota dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë

në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të komunitetit të tyre. Kjo u krijon vajzave dëme ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe psikologjike. Martesa e hershme u mohon vajzave të moshës shkollore mundësinë për arsimim të mëtejshëm, rritjen personale dhe profesionale përtej asaj të një zonje shtëpie. Edhe në qoftë se vajzat e martuara do të duan të vazhdojnë arsimimin e tyre, praktikisht ato janë të përjashtuara sepse kanë për të bërë punët e shtëpisë, për të punuar në mënyrë që të ndihmojnë familjen e tyre ose të kujdesen për të porsalindurit. Ato janë zakonisht në një disavantazh ekonomik, sepse nuk kanë as arsimin e as aftësi që janë të lidhura me nivele të caktuara arsimore për të konkurruar në tregun e punës për një punë të paguar mirë. Martesa e hershme është e lidhur edhe me shtatzëninë e hershme e cila ka një efekt negativ në shëndetin e nënave të reja dhe cilësinë e kujdesit për të porsalindurit e tyre.

Sondazhi i kryer nga ekipi i LYRA në shtatë lagje në Prizren, Kosovë, konfirmon se martesat e hershme janë të përhapura në komunitetet romë dhe se kjo ndodh më shumë tek vajzat se sa tek djemtë. Të dhënat e anketës tregojnë se 34% e të anketuarve janë martuar në një moshë më të re se 18 vjet dhe 65% prej tyre ishin vajza. Mbi 76% e të anketuarve meshkuj deklaruan se partnerja i tyre ishte më e re se 18 vjeç në momentin e martesës, ndërsa më pak se 27% e femrave pohojnë të njëjtën gjë. Rreth 63% e të anketuarve mendojnë se martesat e hershme janë të përhapura në lagjen e tyre. Përveç vështirësive financiare, të cilat janë diskutuar në seksionin e mëparshëm, traditat, zakonet dhe mentaliteti janë ndër arsyet kryesore për martesat e hershme.

Martesa e hershme është një fenomen që i ka rrënjët thellë në kulturën dhe traditën e popullit rom. Megjithatë, kultura dhe tradita nuk duhet të shihen si të pandryshueshme dhe në këtë mënyrë si i vetmi faktor për këtë fenomen. Variablat si privimi ekonomik dhe analfabetizmi, sidomos i nënave, kanë një kontribut të rëndësishëm në vazhdimësinë e martesave të hershme. Përqindja e martesave të hershme ka rënë në vendet dhe shtresat e shoqërive ku niveli i arsimit është rritur dhe varfëria është ulur.

KAPITULLI IV

EDUKIMI

Në vitin 1954, 36 vjet para se KDF të hynte në fuqi, Brown kundrejt Bordit të Arsimit në SHBA njohu arsimin si bazë e një jete të suksesshme dhe produktive:

Sot, arsimi është ndoshta funksioni më i rëndësishëm i shtetit dhe qeverive lokale. Ligjet për shkollimin e detyrueshëm dhe shpenzimet e mëdha për arsimin shprehin njohjen tonë për rëndësinë e edukimit të shoqërisë demokratike. Kjo është e nevojshme në përmbushjen e përgjegjësive tona publike më themelore, madje duke përfshirë edhe shërbimin në forcat e armatosura. Ky është themeli i qytetarisë së mirë. Sot ky është një instrument kryesor në zgjimin tek fëmija të vlerave kulturore, në përgatitjen e tij për trajnim të mëvonshëm profesional, dhe për të ndihmuar atë për t'u përshtatur normalisht në mjedisin e tij. Në ditët e sotme, është e sigurt se çdo fëmijë nuk mund të ketë sukses në jetë, nëse atij i është mohuar mundësia për arsim. Një mundësi të tillë, ku shteti ka ndërmarrë për t'ia siguruar atë, është një e drejtë që duhet të vihet në dispozicion për të gjithë e në kushte të barabarta.²²

Sot, 193 vende e kanë ratifikuar ose qasur Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës e cila i kushton plotësisht nenet 28 dhe 29 të drejtës së fëmijës për arsimim, duke specifikuar edhe detyrat e shtetit për të bërë arsimin e detyrueshëm dhe atë të mesëm të arritshëm për të gjithë dhe për të institucionalizuar politika që rrisin frekuentimin e shkollës dhe reduktojnë përqindjen e braktisjes. Neni 23 i mandateve KDF jep direktiva për të siguruar arsimin për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe në nenet 2 dhe 30 kërkojnë që çdo grup i pakicës të trajtohet në mënyrë të barabartë. Edhe pse qeveritë e tre vendeve kanë përfshirë arsimin e romëve në planet dhe strategjitë e tyre, statistikat (ndonjëherë të paplota ose të pasakta), studimet cilësore dhe informacionet nga organizata që punojnë

me popullsi rome paraqesin një situatë të tmerrshme në lidhje me nivelin e arsimit të romëve. Romët, ashkaltë dhe egjiptianët kanë përqindje më të ulëta të regjistrimit në shkollë dhe të përfundimit të arsimit të detyrueshëm, si dhe përqindjet më të larta të braktisjes së shkollës dhe të mungesave pa arsye në krahasim me popullsinë jo-rome.

Në **Shqipëri, vetëm 34% e romëve** janë të regjistruar **në arsimin parashkollor** në krahasim me 57% në popullsisë jo rome. Në **arsimin e detyruar**, shkalla e regjistrimit romëve është **48%** në krahasim me 91% për jo-romët. Mesatarja e viteve të shkollimit për romët në Shqipëri është 4.4 vjet, ndërsa për jo-romët është 9,6 vjet.²³

Në Bosnje- Hercegovinë, të dhënat nga viti 2007 tregojnë se vetëm **50% e fëmijëve romë** të moshës shkollore shkojnë në shkollë në krahasim me 92,8-98,9% të popullsisë së përgjithshme. Vetëm 20% e romëve që diplomohen në arsimin e detyrueshëm regjistrohen në arsimin e mesëm e të lartë në krahasim me 56,8-76% të popullsisë së përgjithshme.²⁴

Të dhënat për popullsinë rome vetëm në **Kosovë** tregojnë se **32.4%** e romëve përfunduan arsimin fillor në vitin 2004.²⁵ Të dhënat e UNDP-së tregojnë se në vitin 2004 në mesin e popullsisë romë, ashkali dhe egjiptiane 75% ndoqën arsimin fillor, 25% ndoqën arsimin e mesëm dhe *vetëm 1.4% morën pjesë ose përfunduan shkollën e mesme*.²⁶ Lidhur me normat e shkrim-leximit, UNDP raporton se 65% e romëve nga moshë 15 në 24 vjeç dhe 76% e romëve 25-34 vjeç janë shkolluar në krahasim me 98% të popullsisë jo-rome.²⁷

Ekziston një konsensus, në mesin e dijetarëve dhe profesionistëve në fushën e arsimit dhe të shkencës sociale, që niveli i arsimit është ndër faktorët më të rëndësishëm që përcaktojnë statusin e ardhshëm të një individi për punësim, nivelin e të ardhurave, shëndetin e tyre dhe të të vegjëlve të tyre dhe zhvillimin, si dhe për statusin e tyre në shoqëri. Duke pasur këtë në mendje, ekipet kërkimore me pjesëmarrje LYRA u fokusuan veçanërisht tek arsimi. Në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, rezultatet e hulumtimit me pjesëmarrje konfirmojnë se ekziston një hendek i madh në arritjen arsimore mes komuniteteve jo-rome dhe ato rome. Ka një shkallë të lartë të analfabetizmit dhe braktisjes së shkollës fillore, disa romë vazhdojnë dhe përfundojnë arsimin e tyre të mesëm dhe shumë pak romë marrin pjesë në aktivitetet jashtëshkollore në shkollat e tyre apo klubet e ndryshme në zonat ku banojnë. Arsytet për braktisjen e shkollës mund të grupohen në arsye ekonomike

(varfëria dhe papunësia), kulturore (martesat e hershme dhe jo me vlerë të mjaftueshme për të vlerësuar arsimin) dhe qëndrimet e shumicës së popullsisë ndaj popullatës rome (diskriminuese dhe përjashtuese).

Të dhënat nga Save the Children në Bosnje-Hercegovinë dhe Raporti Kombëtar Kërkimor me pjesëmarrje (2014) tregojnë se 8.73% e të anketuarve janë analfabetë dhe 16,87% nuk kanë frekuentuar shkollën në të kaluarën dhe ndoshta janë analfabetë. Pak më shumë se 13% kanë braktisur shkollën fillore, 28,31% kanë përfunduar shkollën fillore, 19,88% kanë përfunduar arsimin e mesëm, 11,44% kanë ndjekur ndonjë formë arsimimi profesional pas përfundimit të shkollës fillore, dhe 1.50% kanë ndjekur arsimin e lartë apo aspirojnë masterin. Sa herë që është pyetur në lidhje me pjesëmarrjen

Tabela 4.1. Niveli i edukimit dhe arsimimit të të anketuarve në Bosnje-Hercegovinë sipas qyteteve

| Niveli i arsimit / Edukimi | Banja Luka | | Bijeljina | | Mostar ²⁸ | | Sarajeva | | Tuzla | | Totali | |
|----------------------------------|------------|-------|-----------|-------|----------------------|-------|------------------|-------|-------|-------|--------|-------|
| | # | % | # | % | # | % | # | % | # | % | # | % |
| Analfabet | n / a | n / a | 23 | 46 | n / a | n / a | n / a | n / a | 6 | 8,96 | 29 | 8,73 |
| Nuk shkojnë në shkollë | 12 | 30,77 | n / a | n / a | 29 | 22,14 | 15 ²⁹ | 30 | n / a | n / a | 56 | 16,87 |
| Arsimim fillor i paplotë | n / a | n / a | 4 | 8 | 15 | 11,45 | 14 | 28 | 11 | 16,42 | 44 | 13,25 |
| Arsimi fillor | 6 | 15,38 | 17 | 34 | 26 | 19,85 | 19 ³⁰ | 38 | 26 | 38,81 | 94 | 28,31 |
| Shkollë profesionale tre-vjeçare | 7 | 17,95 | n / a | n / a | n / a | n / a | n / a | n / a | n / a | n / a | 7 | 2,11 |
| Shkollë e mesme | 12 | 30,77 | 5 | 10 | 28 | 21,37 | 2 | 4 | 24 | 35,82 | 66 | 19,88 |
| Universiteti | 1 | 2,56 | 1 | 2 | 2 | 1,53 | n / a | n / a | n / a | n / a | 4 | 1,20 |
| Të diplomuar | 1 | 2,56 | n / a | n / a | | n / a | n / a | n / a | n / a | n / a | 1 | .30 |
| Një formë tjetër e arsimimit | n / a | n / a | n / a | n / a | 31 | 23,66 | n / a | n / a | n / a | n / a | 31 | 9,34 |
| N | 39 | 100 | 50 | 100 | 131 | 100 | 50 | 100 | 67 | 100 | 332 | 100 |

në aktivitete jashtëshkollore apo klube, shumica e romëve boshnjakë raportoi se ata nuk marrin pjesë ose për shkak të mungesës së informacionit, indiferencës prindërve, mungesës së vetëdijes ndaj rëndësisë së tyre apo mungesës së mjeteve financiare për të paguar kurset e propozuara.

Të dhënat nga Raporti Kombëtar Kosovar Kërkimor me pjesëmarrje tregojnë se në Prizren, 16% e fëmijëve romë për të cilët është mbledhur informacion (ose direkt ose nëpërmjet prindërve të tyre) nuk kanë vijuar shkollën, shumica e të cilëve nuk kanë qenë në shkollë për më shumë se një vit. Në të njëjtin qytet, mbi 32% e të anketuarve të sondazhit mbi martesat e hershme kanë raportuar se nuk kanë përfunduar arsimin e detyruar, 11% ishin analfabetë, 44 % kishin mbaruar shkollën fillore dhe 20.2% kishin përfunduar shkollën e mesme. Në Gjakovë, rreth 33% e fëmijëve të identifikuar me nevoja të veçanta nuk ndjekin asnjë lloj arsimimi. Nga ata që ndjekin shkollën, 38% vijojnë arsimin në klasa të zakonshme, 43% në klasa të veçanta në shkollat e rregullta dhe 19% në shkolla për fëmijë me nevoja të veçanta. Në Gjakovë, Kosovë, 34% e fëmijëve romë nuk ndjekin kurse të gjuhës shqipe, angleze apo matematike të ofruara si kurse jashtëshkollore.

Arsimimi i dobët i popullatës romë është një realitet i zymtë i lidhur ngushtë me kushtet e dobëta ekonomike, papunësinë, diskriminimin, përjashtimin social dhe nganjëherë indiferencës që prindërit romë kanë në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre. Shumica e politikave të mundshme arsimore aktuale edhe kur janë të krijuara me qëllim që të përfshijnë romët apo grupe të tjera të cenueshme nuk kanë qenë shumë efektive në arritjen e këtij qëllimi. Për të rritur nivelin e arsimimit të të rinjve romë është e nevojshme të sigurohet përfshirja e romëve në programet ndër sektoriale që trajtojnë çështjet e mësipërme.

MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN E ROMËVE TË RINJ

Pjesëmarrësit e projektit LYRA dhe menaxherët tashmë mund të shikojnë ato ditë kur planifikonin këtë projekt rajonal dhe pyesnin veten nëse do të përbënte ndonjë ndryshim në lidhje me atë çka synohej. Dy vite më vonë, një rrjet i të rinjve romë dhe jo-romë në të tre vendet punon në mënyrë aktive për t'u zhvilluar si ekip por dhe si individ. Në ekip ata kërkojnë të arrijnë qëllimet programore të cilat i prunë së bashku: mos diskriminimi dhe përfshirja sociale e romëve. Individualisht, çdo pjesëmarrës ka fituar aftësi praktike që të jetë një anëtar më produktiv dhe aktiv i shoqërisë; ka fituar vetëbesimin dhe vetë-respekt; dhe në përgjithësi, shumë prej tyre e dinë se çfarë duan të bëjnë me jetën e tyre. Këto përfitime individuale dhe në ekip kanë nevojë për nxitje të mëtejshme dhe krijimin e një rrjeti më të gjerë brenda dhe midis tre vendeve, në mënyrë që të jenë edhe më të qëndrueshme. Pjesa tjetër e këtij kapitulli sjell disa nga këto arritje individuale dhe në ekip, si dëshmi e ndikimit të prekshëm dhe jo të prekshëm që projekti LYRA ka sjellë tek të rinjtë dhe komunitetet e tyre; dhe si dëshmi se ndërhyrje të tilla sjellin fryte dhe duhet të inkurajohen në të ardhmen.

Shqipëria

“Një qendër rinore për të gjithë”

Ekipi shqiptar LYRA në qytezën e Roskovecit mbrojti me sukses projektin e një qendre për të rinj romë dhe jo-romë në të cilën do të organizohen aktivitetet që do të mbledhin së bashku të rinjtë e të gjitha përkatësive etnike. Fokus grupi i organizuar për

të identifikuar problemet kryesore me të cilat ballafaqohet komuniteti rom vuri në dukje probleme të përbashkëta si diskriminimi, papunësia, aftësi të dobëta për punë, shërbime të varfëria arsimimi dhe kujdes shëndetësor, varfëria dhe mungesa e aktiviteteve rekreative dhe vendeve për të pasur aktivitete të tilla. Mungesa e aktiviteteve rekreative dhe hapësirë dukej se përbënte shqetësimin më të vogël për të rinjtë romë në Roskovec. Megjithatë, ekipi hulumtues me pjesëmarrjeit LYRA u fokusua në advokimin për krijimin e një qendre rinore për tri arsye kryesore. Së pari, ata mund të përdorin këtë hapësirë për të planifikuar dhe organizuar aktivitete rekreative, duke ndihmuar ndërtimin e një mjedisi pozitiv dhe shpresëdhënës. Së dyti, kjo hapësirë mund të përdoret si një vend ku të rinjtë romë dhe jo-romë kalojnë kohë dhe punojnë së bashku, duke njohur më mirë njëri-tjetrin në një mjedis të përbashkët, duke ndihmuar kështu për të zbehur mosbesimin dhe për të rritur mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve jo-rome dhe rome. Dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, një probabilitet i lartë suksesi sepse ishte një çështje që varej nga autoritetet lokale e jo në nivel kombëtar e cila do të përfshinte një numër të gjerë institucionesh dhe organizatash advokuese.

Ekipi LYRA në Roskovec konstatoi se nuk kishte shumë hapësira të mundshme publike që mund të shërbenin si qendër rinore. Shtëpia e Kulturës në Roskovec ishte vendi më i përshtatshëm për të ngritur një qendër rinore. Ekipi LYRA dialogoi me komunën e Roskovecit, kryetarin dhe këshillin komunal, mbi punën e tyre, për shkak se komuna ka në administrim Shtëpinë e Kulturës. Në një takim të përbashkët me kryetarin e bashkisë dhe Këshillin komunal të Roskovecit, ekipi LYRA prezantoi të dhënat e nxjerra nga puna e fokus grupit në lidhje me gjendjen aktuale të të rinjve romë dhe jo-romë. Ata theksuan nevojën për një qendër rinore dhe paraqitën arsyet pse një qendër e tillë është e dobishme për të gjithë komunitetin, në qytetën e Roskovecit. Kryetari i Bashkisë së Roskovecit i mbështetur nga Këshilli i Komunës pranoi se mungesa e një qendre rekreative rinore duhet të ekzistonte prej kohësh. Më vonë, një nga dhomat në Shtëpinë e Kulturës u caktua për qendër rinore.

Ekipi LYRA në Roskovec ndërkohë që feston suksesin e punës së tyre advokuese, është gjithashtu i vetëdijshëm se ky është vetëm hapi i parë. Ata duhet të sistemojnë qendrën e tyre dhe ta bëjnë atë funksionale. Megjithatë, në fund të projektit të tyre të parë të hulumtimit me pjesëmarrje ata ndihen të pajisur më mirë për të trajtuar problemet me të cilat ata përballen. Ata kanë mësuar se si të identifikojnë dhe analizojnë një problem, të

identifikojnë zgjidhjet e mundshme, projektimin e planeve të veprimit dhe të veprjnë në përputhje me rrethanat. Çka është më e rëndësishme, është se ata kanë vënë në praktikë çdo hap dhe korrën frytet e punës së tyre të vështirë.

Bosnje- Hercegovinë³¹

LYRA (/ 'laɾəɾə/; nga Latinishtja, nga Greqishtja [κλύρα] është një plejadë e vogël) Kjo është një nga 48 yjësitë e gjetura nga astronomi i shekullit të II, Ptolemeu, dhe është një nga 88 yjësitë e njohura nga Bashkimi Ndërkombëtar Astronomik. Ylli i saj kryesor Vega (Abhijit në sanskritisht) një cep i Trekëndëshit Veror është një nga yjet më me ndriçim në qiell.

Praktika: një shans për sukses

Gjetja e yjeve më të shndritur në qiell - ishte ideja e LYRA-s (Liderëve të rinj romë në veprim) në projektin e realizuar në të tre vendet: Shqipëri, Kosovë dhe Bosnje-Hercegovinë; zbulimi i yjeve në gjirin e rinisë rome, liderët e ardhshëm të komuniteteve rome në këto vende.

Në Bosnje-Hercegovinë procesi nuk ishte i lehtë - ishte e vështirë për të gjetur kandidatët të cilët do të plotësonin një grup të tërë të kriteresh të përcaktuara nga projekti, kështu që në disa raste morëm në konsideratë aplikantët që nuk plotësonin kriteret në nivelin e arsimimit, moshës, etj. Pasi identifikua më rinjtë me potencial suksesi, projekti ishte pothuajse i garantuar. Në pesë qytete të vendit Sarajevë, Tuzla, Banja Luka, Bijeljinës dhe Mostar kemi krijuar një grup bazë me 18 liderë të rinj romë, tre në çdo qytet, të cilët ishin të aftë për të udhëhequr dhe angazhuar një grup më të gjerë prej 75 romë dhe jo-romë për të kryer kërkime me pjesëmarrje dhe për përmirësimin e situatës për romët në komunitetet e tyre lokale. Pas një sërë trajnimesh, 18 liderë të rinj romë u fuqizuan për t'u angazhuar në aktivitete dhe detyra të parashikuara nga projekti, por edhe për të kryer rolin udhëheqës në komunitetet e tyre. Atyre iu dha një mundësi shtesë për ta

bërë këtë me anë të programit të praktikës të lehtësuar nga Save the Children. Para se të merrnin pjesë në programin e stazhit, Save the Children iu ofroi atyre me një trajnim se si të prezantojnë veten në një mjedis biznesi, si të hartojnë një CV dhe një letër motivuese.

“Programi i praktikës, i organizuar përmes projektit LYRA, është një nga ndërhyrjet me të rinjtë romë në Bosnje-Hercegovinë. Kjo ishte një mundësi unike për këta të rinj për të punuar, për t’u paguar për punën e tyre dhe për të provuar veten e tyre ndaj punëdhënësve, gjë të cilën ata e kryen shumë mirë” thotë Amir Basic, koordinatori i projektit LYRA pranë Save the Children. Përzgjedhja e kandidatëve ishte konkurruese. ***“18 kandidatëve iu kërkuar të shkruajnë CV-në e tyre dhe letra motivuese dhe t’ua paraqesin punëdhënësit të ardhshëm. Punëdhënësit vendosën në bazë të aplikacioneve, se kë dëshironin të punësonin,”*** shpjegon Amir Basic.

Dhe kështu ndodhi, të rinjtë e zgjedhur kanë provuar veten e tyre si punonjës të etur për të mësuar dhe për të lënë një përshtypje të mirë. Ata shfrytëzuan siç duhej mundësinë që iu ishte dhënë dhe për të gjithë gjithçka eci siç duhej: atyre iu ofrua mundësia për të vazhduar punën për organizatat në të cilat punonin si praktikantë. Shtatë të rinj romë: Almir dhe Fatima në Bijelinë, Denis në Tuzla, Albert dhe Ermin në Mostar dhe Dragana dhe Mersiha në Banja Luka vazhduan punën për organizatat pas përfundimit të detyrës praktike, si pjesëtarë të këtyre organizatave apo si vullnetarë. Njëra prej tyre, Bahrudina në Tuzla, në sajë të eksperiencës së fituar dhe cilësive të saj, është e punësuar tashmë në një organizatë tjetër nga ajo ku kreu praktikën. Ramizit nga Sarajeva iu premtua se do të rifillonte punën sapo të siguroheshin disa fonde shtesë nga Shërbimi publik për parandalimin, pritjen dhe mbrojtjen e fëmijëve ndaj rreziqeve, ku ai ishte praktikant për pesë muaj.

“Sigurisht që të rinjtë romë përmirësuan dhe bënë ndryshime në jetën e tyre. Është shumë e rëndësishme për ne që ata të qëndrojnë për të punuar në komunitetet rome, me fëmijët romë, - thotë Andrea Zeravic drejtore e Save the Children për Ballkanin Verior e Perëndimor.

Një mundësi vlen më shumë se një mijë fjalë

“Qëllimi im është të bëhem burrë me forcat e mia; të eci vetë. Stafii i Save the Children më ndihmoi shumë. Falë tyre isha në gjendje të punoja dhe fitoja pará”,

kështu fillon historia e Ramiz Spasolit mbi përfshirjen e tij në projektin e Save the Children. Ramizi është 20 vjeç. Është rom. Lindur e rritur në Sarajevë. Jeta e tij së bashku me 4 vëllezërit, 2 motrat dhe babanë e tij të punësuar nuk është aspak e lehtë. Tani ata janë 18 vetë në një shtëpi, me vëllezërit dhe motrat dhe familjet e tyre.

Ramizi gjithmonë ka dashur të shkojë në shkollë. Ai ishte i pari dhe i vetmi nga vëllezërit e motrat e tij që shkoi në shkollë. Pas përfundimit të shkollës fillore, ku ai ishte një nxënës shumë i mirë, ai ndoqi shkollën e mesme. **“Kisha kaq shumë dëshirë për arsimim. Përfundova arsimin e mesëm profesional, edhe pse ishte pak më i vështirë se shkolla fillore, sepse në atë kohë fëmijët e vëllezërve të mi filluan shkollën. Nuk kishim të ardhura të mjaftueshme për të gjithë. Doja që ata të kishin çdo gjë që u nevojitej, por nuk kishim pará të mjaftueshme për të blerë dhe librat e mi”**, shpjegon Ramizi. Megjithatë edhe pse me nota të ulëta Ramizi përfundoi arsimin e mesëm.

I rekomanduar nga një prej mësuesve e tij, Ramizi u përfshi në projektin LYRA që në fillim. Ai ishte një nga tre liderët e rinj romë të identifikuar në Sarajevë. Ky ishte projekti i parë në të cilin ai merrte pjesë ndonjëherë. Ramizi nuk kishte pasur kontakte paraprake me sektorin e OJQ-ve. Por Ramizi dha prova se ishte një përzgjedhje e shkëlqyer. Ai tregoi përkushtim të madh ndaj projektit, ekipit dhe detyrave të besuara.

Pas përfundimit të një kursi për të mësuar se si shkruhej një CV dhe një letër motivimi të organizuar nga Save the Children, Ramizi dorëzoi kërkesën e tij në Qendrën Disiplinore, një institucion publik që punon me fëmijët që kanë probleme me ligjin, me rrugën dhe fëmijët në rrezik. Qendra drejton Shërbimin për parandalimin, pritjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në rrezik, ish Qendra për fëmijët e rrugës e themeluar nga Save the Children dhe Qendra për punën sociale e Kantonit të Sarajevës, e cila më vonë u bë pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale të kantonit përmes integritit në Qendrën Disiplinore. Qendra zgjodhi Ramizin për t’u bërë anëtar i ekipit të tyre për pesë muajt në vijim.

“Në fillim, nuk e dija saktësisht se çfarë ishte e nevojshme të bëja, si të vepra. Mendova se nuk do të isha në gjendje të bëja diçka të tillë. Por falë kolegëve të mi, të cilët më inkurajuan për të marrë pjesë në mënyrë aktive, fillova të bëja gjithçka që kisha mundësi. Pas këtyre pesë muajve, u krijua një lidhje e ngushte mes stafit të Qendrës, fëmijëve dhe mua. Përvoja e punës në Qendër më ndryshoi shumë. Kam

takuar njerëz të ndryshëm dhe unë mund të shoh se si mendimi im ka ndryshuar tashmë”, thotë Ramizi për përvojën e tij praktike. **“Aktualisht nuk jam në punë, sepse nuk ka fonde të mjaftueshme në dispozicion, por ata më premtuan se do të shikonin për mundësitë për të më mbajtur në gjirin e ekipit”,** vazhdon ai.

“Jam shumë i kënaqur që Ramizi fitoi një shkallë të caktuar vetë-besimi ndërsa punonte në Qendrën për fëmijë dhe njohu në vetvete cilësi që ai nuk i dinte se i zotëronte”, thotë Selma Cokalovic, eksperte bashkëpunëtoare në Shërbimin, që ka drejtuar Ramizin gjatë stazhit të tij. **“Ai është një figurë pozitive dhe kjo ishte tejet e rëndësishme për fëmijët që vijnë në qendrën tonë,”** vazhdon Selma.

Sipas Amir Basic, Save the Children : **“Ramizi tregoi afrim të veçantë me fëmijët, dhe një qasje pedagogjike. Ai ndoshta është nga të vetmit që ka treguar përparimin më të madh ndër të gjithë të rinjtë romë në Bosnje-Hercegovinë të përfshirë në projekt LYRA.”** Save the Children do të vazhdojë të punojë për të gjetur një zgjidhje më të qëndrueshme për punësimin e Ramizit.

Kosovë

Fatlumi është pjesë e ndryshimit të perceptimeve ndaj komunitetit rom.³²

Në Kosovë, kalimi i të rinjve romë nga fëmijëria në moshën e rritur është penguar nga mungesa e mundësive brenda dhe jashtë komuniteteve të tyre, si dhe nga vështirësitë në qasjen në të drejtat e tyre njerëzore, pasi ata përballen me diskriminim strukturor dhe marginalizim. Paragjykimet dhe stereotipat janë të përhapur gjerësisht dhe shpesh mbeten të pa parashtruara si në politikë por dhe në shoqëri.

“Sot, nga pjesa më e madhe, romët perceptohen si njerëz që dinë vetëm të mbledhin kuti teneqeje dhe që i gjen vetëm pranë kazanëve të plehrave. Dua të ndryshoj perceptimin mbi komunitetin rom dhe të zbeh stereotipat”, thotë Fatlum Kryeziu, një 20 vjeçar rom nga qyteti i Prizrenit, Kosovë.

Fatlumi tashmë është pjesëtar i Liderëve - të Rinj Romë në Veprim (LYRA) projekti rajonal që zbatohet në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Si një nga 60 romët

dhe jo-romët liderë të rinj, projekti ka për qëllim të fuqizojë liderët për të identifikuar problemet e përbashkëta që kanë të bëjnë me përjashtimin social dhe diskriminimin me të cilat përballen romët, dhe të krijojë aktivitete për të adresuar këto probleme përmes shkëmbimit të ideve dhe përvojave, si dhe krijimin e rrjeteve ndërkufitare bashkëpunimi, angazhimit e shoqërisë civile dhe advokimit pranë institucioneve shtetërore dhe mekanizmave ndërkombëtarë që merren me çështjet rome.

Fatlumi u rrit në një familje të përbërë nga gjashtë vetë, në një lagje shumë të varfër dhe të pazhvilluar e kryesisht të populluar nga romë, në Prizren. **“Babai im ka punuar si muzikant dhe udhëtonte gjatë gjithë kohës, unë kaloja shumë kohë me gjyshet dhe isha i përkëdhelur. Nëna, ishte kështjella ime dhe pavarësisht nga fakti se ajo kishte mbaruar vetëm klasën e 8, ajo gjithmonë më ka mbështetur shtyrë në shkollë dhe gjithashtu që të jem aktiv në bërjen e ndryshimeve të mundshme. Ajo është “luanësja ime” - thotë Fatlumi.**

Vëmendja relativisht e ulët në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare mbi problemet specifike të të rinjve romë, e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë angazhimin e të rinjve romë në mënyrë efektive për t’u bërë qytetarë liderë të ndryshimit. Mënyra kryesore për të ndalur ciklin vicioz dhe duke fituar përfaqësim pozitiv brenda shoqërisë është rritja e përfshirjes sociale dhe qytetarisë aktive të të rinjve romë. Rritja e aftësisë së të rinjve romë për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe të komunitetit në mënyrë të organizuar është një çështje kritike.

Përfshirja e Fatlumi në projektin LYRA në 2013 nisi në formë vullnetare dhe në vitin 2014 u përzgjedh si lider. Ai mori pjesë në projektin Pjesëmarrje në hulumtimin me pjesëmarrje, të kryer në vitin 2013, në Prizren, ku ata vëzhguan braktisjen e arsimit dhe martesat e hershme tek romët. Pas përfundimit të diskutimeve, të rinjtë dhe anëtarët e organizatës propozuan rekomandime për aktivitete të menjëhershme që do të organizoheshin në komunitetet rome për të adresuar problemet e identifikuara. Këto konstatime, të cilat Fatlumi kreu në qytetin e Prizrenit, u ndanë si në nivel lokal por edhe në atë kombëtar, me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, duke përfshirë dhe median.

“Pjesëmarrja në projekt më ndihmoi me të vërtetë për të ndërtuar aftësitë e mia në hulumtimin shkencor, hartimin e pyetësorëve dhe se si të ngrihet zëri e si të

çohen përpara çështje të caktuara, të tilla si trajtimin e Ombudspersonin. Besoj se investimi në arsim dhe trajnim është i rëndësishëm, në mënyrë që të krijohen mundësi për punë, sepse kjo është rruga kryesore për të reduktuar diskriminimin. Pjesa më e madhe e integritit ndodh për shkak të nevojës dhe jo domosdoshmërisht nga ligji në vend. Për shembull, nëse je bukëpjekësi më i miri në qytet, njerëzit nuk pyesin se çfarë je, për aq kohë sa je më i miri në qytet ata do të vijnë tek ty. ”

Fatlumi thotë se ai dëshiron të jetë një frymëzim për të tjerët dhe të bëjë ndryshimet e mundshme për ata që janë në komunitetin e tij falë këtij projekti por edhe më tej. Ai do të vazhdojë studimet e tij në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Muzikës, ndërsa do të zhvillojë aftësi të tjera duke bërë një stazh tre mujor në Ministrinë e Bujqësisë në Kosovë.



KONKLUZIONET

- I. Të dhënat nga hulumtimi me pjesëmarrje në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë nxjerrin në pah problemet e përbashkëta me të cilat përballen të rinjtë romë, egjiptianë dhe ashkali, dhe në këto tre vende janë: diskriminimi, përjashtimi social dhe edukimi i dobët. Metodatat e hulumtimit dhe instrumentet ishin të ndryshme nga një vend në tjetrin dhe krahasimi i drejtpërdrejtë i tyre nuk është i mundur. Megjithatë, fakti se konkluzionet në lidhje me perceptimet dhe mendimet rome për problemet e tyre dhe shkaqet e mundshme të këtyre problemeve të konvergjuara vë themelet për një veprim të përbashkët në nivel rajonal. Kjo konvergjencë tregon se hulumtimi me pjesëmarrje në nivel rajonal mund të trajtojë më me efektivitet problemet e përbashkëta rajonale.
- II. Hulumtuesit LYRA kanë konstatuar se diskriminimi shoqëror dhe individual kundër romëve, ashkalive dhe egjiptianëve është i përhapur në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Në këto vende nuk ka ligje, rregullore apo politika diskriminuese. Megjithatë, ka dëshmi anekdotike individësh paragjykues, të vetëdijshëm apo jo, që punojnë në institucionet publike dhe që bartin paragjykime të përhapura gjerësisht në shoqëri kundër romëve, popullsisë egjiptiane dhe ashkali, e që përdorin praktika diskriminuese apo mbajnë qëndrime diskriminuese ndaj romëve. Disa përfaqësues institucionalë kanë shprehur një këndvështrim ligjor të diskriminimit të romëve, duke neglizhuar diskriminimin që vazhdon të bëhet në jetën e romëve.
- III. Mungesa e të kuptuarit dhe vetëdijes nga ana e popullsisë rome në lidhje me diskriminimin konceptual dhe të praktikuar kundër tyre i ka me shumë gjasa rrënjët në një histori të gjatë diskriminimi i shoqëruar me një nivel të ulët arsimimi, mos

angazhimi qytetar dhe varfërie të skajshme. Në një kontekst të tillë, ligjet dhe politikat jo-diskriminuese nuk janë të mjaftueshme për të thyer ciklin e diskriminimit ndaj popullsisë rome. Rritja e të kuptuarit dhe vetëdijes se çfarë është diskriminimi dhe se si diskriminimi ndaj romëve është praktikuar nga popullsitë rome dhe jo-rome është çelësi për të ndikuar në situatën e tanishme.

- IV. Diskriminimi gjinor me rrënjë në kulturën dhe kushtet ekonomike ndodh në gjirin popullsisë rome, egjiptiane dhe ashkali. Vajzat janë subjekt i martesave të hershme e në mënyrë të konsiderueshme më shumë se djemtë në komunitetet rome në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Si rezultat, braktisja e shkollës ndodh në një moshë më të hershme dhe ndoshta më shpesh tek vajzat rome se sa tek djemtë romë. Për më tepër, përjashtimi social i vajzave rome përfshin më shumë dimensione dhe më të thella se përjashtimi i djemve rome.
- V. Diskriminimi dhe ndarja e të rinjve romë ndodh në shkolla, edhe pse fenomene të tilla nuk janë institucionalizuar. Mësuesit, të vetëdijshëm apo jo, veprojnë në mënyrë të tillë që shumë të rinj romë ndihen të diskriminuar edhe pse ata domosdoshmërisht nuk do të ishin në gjendje ta quanin atë diskriminim. Kërkime të mëtejshme sistematike mund të jenë të nevojshme për të nxjerrë në pah ekzistencën e diskriminimit të nxënësve romë në shkolla, sepse pranimi i dukurive të dënueshme ligjërisht dhe moralisht të papranueshme siç është diskriminimi i bazuar në përkatësinë etnike nuk pranohet haptazi nga mësuesit dhe drejtuesit e arsimit.
- VI. Mungesa e të dhënave të ndara sipas përkatësisë etnike apo të dhënave me cilësi të dobët mbi grupet etnike vë bazat për diskriminim ndaj popullsisë rome dhe të politikave që me shumë gjasa nuk adresojnë saktë problemet e romëve. Politikat e bazuara mbi dëshmi kanë nevojë për të dhëna të një cilësie më të lartë e të zbërthyer sipas përkatësive etnike.
- VII. Përjashtimi social i të rinjve romë, egjiptianë dhe ashkali ndodh në fushat ekonomike, identitetitare, gjinore dhe politike. Në këto vende, shumica e të rinjve romë dhe familjet e tyre jetojnë në varfëri, me pak perspektiva për një punësim të ligjshëm. Vetëpunësimi predominon në mesin e popullsisë rome. Në njërin anë, vetë-punësimi në ekonominë gri, bazuar kryesisht në mbledhjen e materialeve të riciklueshme dhe

tregtisë, ngre shqetësime në lidhje me sigurinë dhe kushtet në punë, diferencën e ulët të fitimit, shfrytëzimit dhe paligjshmërinë e punësimit. Nga ana tjetër, përqindja e madhe e vetëpunësimit tek romët flet qartë për shpirtin e tyre sipërmarrës dhe me iniciativë, që duhen inkurajuar dhe mbështetur duke rritur aftësitë e tyre në menaxhimin e biznesit. Të rinjtë romë duhet të inkurajohen që të vazhdojnë shkollimin e përgjithshëm apo atë profesional, në mënyrë që të fitojnë aftësi për të rritur punësimin e tyre.

- VIII. Ekipe LYRA kanë zbuluar dy mënyra me të cilat identiteti ushqen përjashtimin social të romëve. Njëra është rrjedhojë e të pasurit një identitet të ndryshëm etnik. Në përgjithësi popullata ka pikëpamje paragjyquese dhe përjashtuese. Mënyra tjetër është e lidhur me gjendjen civile dhe dokumentet e identitetit, mungesa e të cilave ndodh ose për shkak të mungesës së informacionit apo shtetësisë së huaj. Pavarësisht nga natyra e shkaqeve të mungesës së dokumenteve të identitetit, romët që nuk mund të marrin ose nuk dinë se ku dhe si t'i marrin ato janë të përjashtuar nga institucionet e arsimit, sigurimi shëndetësor, udhëtimi apo gjithçka që kërkon një dokument të tillë.
- IX. Të rinjtë romë nuk janë të përfshirë në vendimmarrjen lokale. Kjo është e njohur nga vendim-marrësit dhe laikët që shprehin nevojën që të rinjtë romë dhe jo-romë të përfshihen në vendimmarrjen lokale.
- X. Aftësia e kufizuar është një terren i rëndësishëm për përjashtimin social në arsim. Ndërsa ligjet dhe politikat janë të favorshme për një përfshirje sociale, është e nevojshme që këto ligje dhe politika të zbatohen dhe të integrohen në sistemet arsimore në fusha si ato që kanë të bëjnë me infrastrukturën, pedagogjinë dhe ndërveprime mes kolegëve.
- XI. Martesat e hershme janë të përhapura në gjirin e popullsisë rome. Ky fenomen është i lidhur me nivelin e lartë të braktisjes së shkollës. Dimensioni gjinor në martesat e hershme është veçanërisht i fortë. Në mënyrë të konsiderueshme ka më shumë vajza se sa djem romë që lidhin martesat e hershme. Si rezultat, qoftë për shkak të probalitetit absolut apo punëve që janë të lidhura me gratë, lidhja në martesë, në një familje rome, shtyn më shumë vajzat të lënë shkollën sesa djemtë. Efektet e martesave të hershme, megjithatë, shkojnë përtej fenomenit të braktisjes së shkollës.

Këto efekte janë të lidhura me aftësitë e ulëta në punë, të mos angazhimit qytetar dhe kapaciteteve të ulëta për të ushtruar të drejtat e tyre.

- XII. Arsimi është një temë thelbësore në diskriminimin dhe përjashtimin social të të rinjve romë. Të rinjtë romë ndjekin më pak vite shkollë se jo-romët; ata kanë një përqindje më të lartë të braktisjes së shkollës dhe mungesave pa arsye se jo-romët; ata marrin pjesë më pak në aktivitetet jashtëshkollore sesa jo-romët. Në pak fjalë, të rinjtë romë përfitojnë më pak nga sistemet ekzistuese arsimore sesa të rinjtë jo-romë.



REKOMANDIME

I. Rekomandimet kryesore të politikave

Si pjesë e procesit, pjesëmarrësit LYRA rekomanduan qasje të ndryshme, të politikave dhe veprimeve për të adresuar problemet që identifikuan dhe për të përfunduar aksionet që tashmë kanë ndërmarrë.

Këto rekomandime u zhvilluan më tej duke përfshirë sa më poshtë:

- Të rinjtë romë dhe grupe të tjera vulnerabël, të diskriminuar dhe të përjashtuar nga shoqëria duhet të bëhen të vetëdijshëm se ata do të jenë në gjendje të korrin sukses vetëm kur të marrin në dorë luftën kundër diskriminimit dhe përjashtimit social. Kjo do të thotë që, individualisht dhe si grupe, të rinjtë romë duhet të kërkojnë të trajtohen si të barabartë me bashkëqytetarët e tyre dhe në të njëjtën kohë duhet të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga sistemi ligjor dhe politikat publike për të përmirësuar arsimin, statusin e tyre profesional dhe shëndetësor në shoqëritë ku jetojnë.
- Përjashtimi social dhe diskriminimi kundër të rinjve romë janë fenomene shumëdimensionale të cilat janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Për më tepër, këto dimensione veprojnë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Kjo bën thirrje për ndërhyrje të harmonizuara në shumë nivele e sektorë të cilat pranojnë dhe adresojnë këto probleme si një bashkësi, por pa lënë mënjanë kontekstet e veçanta në të cilat ato ndodhin.
- Mbledhja e të dhënave të reja me cilësi të lartë dhe të zbërthyer sipas përkatësisë etnike, gjinisë, moshës dhe rajonit si dhe përdorimi i të dhënave ekzistuese mbi

romët, egjiptianët dhe ashkalitë duhet të shërbejnë si dëshmi ku do të bazohet hartimi i politikave.

- Qëndrueshmëria e aksioneve romë, egjiptiane dhe ashkali për të përmirësuar jetën e tyre dhe reduktuar diskriminimin mund të sigurohet vetëm kur një masë kritike të rinjsh nga këto komunitete do të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për të iniciuar, zbatuar dhe finalizuar projektet e tyre.
- Programe ndërgjegjësimi e të përqendruara për zhvillimin e fëmijëve dhe, si rrjedhojë, të të drejtave të njeriut, të aftësive të romëve dhe jo-romëve për dallimin e diskriminimit dhe përjashtimit në vendet publike, si dhe rritja e ndërveprimit mes jo-romëve dhe romëve mund të përmirësojë kontekstin në të cilin politikat jo-diskriminuese dhe përfshirëse mund të funksionojnë në mënyrë më efektive dhe efikase.
- Aty ku nuk ekziston një grup qytetar këshillimor i cili duhet të bashkëveprojë me Këshillin bashkiak të qytetit, të rinjtë romë dhe jo-romë mund të iniciojnë krijimin e një grupi të tillë dhe të përdorin atë si një kanal për të shprehur shqetësimet e tyre, çështjet dhe zgjidhjet e problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet e tyre në jetën e përditshme.
- Puna për fuqizimin e të rinjve romë, egjiptianë dhe ashkali nuk duhet të kufizohet vetëm tek të rinjtë. Puna me prindërit e tyre, dhe sidomos me nënat e tyre, është e nevojshme për të ngritur mbështetjen e duhur për fuqizimin e mëtejshëm të të rinjve romë.
- Hulumtimi me pjesëmarrje në nivel rajonal në të ardhmen duhet të përdorë metodologji dhe instrumente të unifikuara, në mënyrë që të sigurohet krahasueshmëria ndër-vende si dhe themele më të forta me pjesëmarrjet politike dhe advokuese në nivel rajonal.

II. Rekomandimet e planit me pjesëmarrje

Plani rajonal LYRA për advokim sugjeron **tre akse kryesore** mbi të cilat të rinjtë romë dhe jo-romë duhet të përqendrohen:

1. Ulja e diskriminimit të të rinjve romë në arsim nëpërmjet rritjes së shkëmbimeve multikulturale, identifikimin e korrigjimin e rasteve të diskriminimit ndaj romëve.
2. Nxitja e përfshirjes sociale për fëmijët dhe rinisë romë në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal.
3. Dhënia e informacionit për komunitetin rom në lidhje me vlerën e regjistrimit civil dhe procedurat që duhet të ndiqen; informimi i administratës mbi detyrimin e tyre për të komunikuar dhe regjistruar të gjitha lindjet në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë.

Për të arritur këto objektiva rrjeti LYRA duhet të punojnë për zgjerimin dhe mbajtjen e tij. Një bashkëpunim i ngushtë me rrjetet ekzistuese, lëvizjet dhe organizatat që tashmë janë të përfshira në aktivitetet e Dekadës së Romëve, ose organizatat që janë të interesuara për t'u përfshirë në lëvizjen për përmirësimin e gjendjes së romëve do të jetë i mundur nëpërmjet një koordinimi efektiv, shmangies së përsëritjes dhe aktiviteteve të kota dhe si rezultat përdorimin efikas të burimeve financiare dhe njerëzore për të arritur qëllimet e deklaruara.

Përdorimi i qasjeve të integruara për të arritur qëllimet e deklaruara mund të jetë më efektiv dhe efikas se sa një qasje veç e veç. Më konkretisht, leksionet që do të krijohen për të trajtuar çështjet e diskriminimit të romëve në shkolla, përjashtimit social dhe nivelit të ulët të regjistrimit civil duhet të integrojnë këto tema së bashku për të prekur një numër sa më të madh fëmijësh dhe mësuesish në një kohë sa më të shkurtër dhe me pak mjete.

Ndërsa fushata e regjistrimit civil të fëmijëve romë mund të kërkojë një qasje të përqendruar kryesisht në procedurat dhe hapat e regjistrimit në një regjistër civil, por

njëkohësisht është e rëndësishme rritja e ndërgjegjësimit tek fëmijët romë dhe prindërit e tyre se ky është një hap që çon drejt uljes së diskriminimit dhe përjashtimit të të rinjve romë.

Lobimi i palëve të interesuara, duke filluar nga ministrinë përkatëse deri në bordet e shkollave apo mësuesit, duhet të shoqërohet me propozime konkrete me pjesëmarrje dhe të realizueshme në mënyrë që të rriten shanset e përfshirjes pozitive të palëve të interesuara si përgjigje e fushatës së advokimit.

Një kombinim i qasjes arsimore së zbatuar me kujdes, qasjes së përvojës së deleguar, qasjes së kontaktit ndër-grupor dhe promovimit të qasjes pozitive dhe marrëdhënieve ndërgrupeve³³ mund të ndihmojë në arritjen këtyre synimeve dhe të mbështesë fitore të mëtejshme me kalimin e kohës.



FUND SHËNIME

- 1 Procesi kërkimor me pjesëmarrje është një metodë angazhimi nëpërmjet të cilit grupe të ndryshëm mund të mbledhen së bashku për të ndarë përvojat dhe të mësojnë nëpërmjet reflektimit kolektiv dhe analizës. Kjo përfshin përdorimin e një cikli planifikimi, marrjen e masave, vëzhgimin, vlerësimin (duke përfshirë vetë-vlerësimin) dhe reflektimin kritik para se të planifikohet hapi në vijim. Karakteristikat e kësaj qasje kërkimore janë si në vijim: fokusi është në hulumtimin i cili ka për qëllim të mundësojë veprimin (mbledhja e pjesëmarrësve dhe e procesit të të dhënave si dhe vendimi me pjesëmarrjeet e mëtejshme në përputhje me rrethanat); vëmendje veçantë i kushtohet marrëdhënies ndërmjet personit që kryen hulumtimet dhe atyre që janë subjekt i hulumtimit. Në kundërshtim me qasjet dhe metodologji e tjera, ata që janë subjekt i kërkimeve në qasjen e procesit kërkimor me pjesëmarrje konsiderohen si partnerë të cilët mund të ndikojnë në zgjedhjen e temave të hulumtimit, të mbledhjes të të dhënave etj. (para përcaktimit të temës kërkimore liderët e rinj janë konsultuar me anëtarët e komunitetit rom); procesi është udhëhequr nga anëtarë të grupit të cilët kanë interes në çështjen që përbën temën e hulumtimit; bashkëpunimi është kyç në çdo fazë të procesit, duke përfshirë diskutimet dhe punën e përbashkët; rezultati i hulumtimit është një veprim konkret, një ndryshim ose përmirësim në lidhje me çështjen që i nënshtrohet hulumtimi.)
- 2 Në tekstin e mëtejshëm termi rom është përdorur për të përshkruar, pa diskriminim të gjitha grupet rome: romë, egjiptian dhe ashkali, udhëtarët ose të ardhurit e pranishëm në vendet e përfshira nga ky studim.)
- 3 Kore, Zini. 2014. Procesi kërkimor me pjesëmarrje : Raporti Kombëtar Shqiptar, Lyra të rinjtë romë në veprim. Save the Children, Shqipëri.
- 4 Save the Children. 2014. Raporti mbi Procesin kërkimor me pjesëmarrje të kryer, romët e rinj në veprim, Bosnje-Hercegovinë.
- 5 Elezaj, Elezaj, Erbëlina. 2014. Pjesëmarrja në projektin kërkimor me pjesëmarrje. Save the Children, Kosovë.
- 6 Kore, Zini. 2014. Procesi kërkimor me pjesëmarrje : Raporti Kombëtar Shqiptar, Lyra të rinjtë romë në veprim. Save the Children, Shqipëri.

- 7 Komunikim me e-mail me Amir Bašić, Udhëheqës i Ekipit Lyra, Save the Children, Bosnjë Hercegovinë.
- 8 Seksi, origjina dhe opinionet nuk do të përmenden kur do të flitet për diskriminim duke nënkuptuar se diskriminimi ndodh në bazë të një ose të kombinimit të këtyre tri karakteristikave.
- 9 Shehan, Frances and Lindwall, Monica. 2008. Përkthimi i drejtave për mos diskriminim në realitet: një hartë nga Save the Children në Suedi mbi të drejtën për mos diskriminim. Save the Children, Suedi.
- 10 Elezaj, Erëblina. National Action Research Report of Kosova/o, fq. 36.
- 11 Këshilli i Bashkimit Europian. 2001. Raporti i Përbashkët për Përfshirjen Sociale. Dokument I5223/01. 13 Shtator 2014 http://ec.europa.eu/employment_social/soc-prot/soc-incl/I5223/part1_en.pdf.
- 12 Në zgjedhjet lokale të vitit 2007 në Shqipëri komuniteti rom në qytetin e Elbasanit u mobilizua në fushatë dhe zgjodhi romët e parë në Këshillin e Qytetit të Elbasanit. Aktualisht nuk ka asnjë përfaqësues i këtij komuniteti në Këshillin e Qytetit të Elbasanit.
- 13 Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, Kombet e Bashkuara, Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. <http://ëëë.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx>
- 14 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës. 2010. Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Përfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Para Universitetin në Kosovë (2010-2015). http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Strategic_plan%20for_organizing_inclusive_education_for_children_with_special_educational_needs_in_pre_university_education_2010_2015.pdf.
- 15 Kosovo Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës. 2011. Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (2011-2016). http://www.entëicklung.at/uploads/media/2c_Kosovo_Education_Strategic_Plan__EN__FINAL_DRAFT.pdf.
- 16 UNICEF. 2012. E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim. Një e drejtë e bazuar në arsimin gjithëpërfshirës. fq.80. http://ëëë.unicef.org/ceecis/IEPositionPaper_ENGLISH.pdf.
- 17 Elezaj, Erëblina. 2014. Projekt kërkimor me pjesëmarrje. Save the Children, Kosovë, Prishtinë: Kosovë.
- 18 HandiKOS Është shoqata e Fëmijëve Paraplegjikë dhe të paralizuar të Kosovës. Kjo organizatë ka për mision të parandalojë aftësitë e kufizuara, të promovojë dhe të ofrojë shërbime për të paaftët dhe të identifikojë e të sigurojë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara.
- 19 Martesa e hershme quhet e ligjshme ose bashkim i ligjshëm i dy personave, kur të paktën njëri prej tyre është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

- 20 Fondacioni Kosovar për një Shoqëri të Hapur (KFOS). 2012. UNFPA. 2012. Martesa e fëmijëve. <http://unfpa.org/ëebdav/site/eeca/shared/documents/publications/KOSOVO%20-%20English.pdf>.
- 21 Assembly Asambleja e Kosovës. 2004. Ligji për Familjen i Kosovës. http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_32_al.pdf. Article 15. Kapaciteti për martesë (1) Kapaciteti për të kryer një lidhje martesore është i lidhur me kapacitet të plotë për të vepruar. (2) Moshë madhore fitohet pas përfundimit të vitit të tetëmbëdhjetë. (3) kapaciteti i plotë për të vepruar fitohet me arritjen e saj apo duke u lidhur në martesë para kësaj moshe. 2. Kushtet për martesë Neni 16. Kushtet për lidhjen e martesës (1) Një person i cili nuk e ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç nuk do të lidhë martesë. (2) Për shkaqe të arsyeshme, gjykata mund të lejojë martesën për një person të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet me kërkesën e tij, në qoftë se konstaton se personi ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e tij martesore dhe për të përmbushur detyrimet e tij martesore. (3) Para vendimit, gjykata do të kërkojë mendimin e Organit të Kujdestarisë dhe do të dëgjojë nga i mituri dhe prindërit / kujdestarët e tij. Gjykata do të dëgjojë personin me të cilin i mituri ka ndërmend të lidhë martesë dhe do të hetojë rrethanat tjera të rëndësishme për vendimin.
- 22 Brown kundra Bordit të Arsimit, 347 SHBA 483 (1954).
- 23 UNDP, Banka Botërore dhe KE. 2012. Romët në Shqipëri. <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>
- 24 Roma Fondi Arsimit për romët. 2009. Përparimi i arsimit të romëve në Bosnje-Hercegovinë. http://www.romaeducationfund.hu/sites/default/files/publications/ca_bosnia_english_2010.pdf.
- 25 Instituti i Shoqërisë së Hapur, Programi për Mbështetjen e Arsimit, Monitorimi Arsim për romët, një bazë statistikore për Europën Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Budapest 2006. Shumica e të dhënave janë të bazuara në llogaritje. Internet: http://www.soros.org/initiatives/esp/articles_publications/publications/monitoring_20061218 Republika e Kosovës. 2009. Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015. http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Strategy_for_the_Integration_of_Roma,_Ashkali_and_Egyptian_communities_2009-2015.pdf
- 26 UNDP. 2004. Raporti i Zhvillimit Njerëzor Kosovë 2004, Prishtinë. Në Republikën e Kosovës. 2009. Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015. http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Strategy_for_the_Integration_of_Roma,_Ashkali_and_Egyptian_communities_2009-2015.pdf
- 27 UNDP. 2005. Fytyrat e Varfërisë. Bratislava. Në Republikën e Kosovës. 2009. Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015. http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Strategy_for_the_Integration_of_Roma,_Ashkali_and_

- 28 Të dhënat në lidhje me nivelin e arsimit janë mbledhur vetëm për romët e moshës shkollore. Nuk ka të dhëna në lidhje me nivelin e arsimit të 25 të anketuarve që nuk ishin të moshës shkollore.
- 29 Kjo statistikë i referohet fëmijëve romë të cilët në kohën e anketës nuk ishin të regjistruar.
- 30 Kjo statistikë i referohet fëmijëve romë të cilët në kohën e sondazhit ndiqnin arsimin fillor.
- 31 Ky seksioni është përgatitur nga Almija Kapidzic, Save the Children Bosnje-Hercegovinë.
- 32 Ky seksion është përgatitur nga Save the Children, Kosovë.
- 33 Shih Planin e Veprimit Rajonal, Projekti Lyra, 2014-2015.

Një qasje edukative. Ekspozimi i nxënësit dhe mësuesit ndaj një informacioni të saktë në lidhje me grupet e tjera u lejon atyre të mësojnë në lidhje me ngjashmëritë dhe dallimet e ndër-grupit. Kur individët kanë informacion të saktë, ata pranojnë më pak stereotipat dhe paragjykimin. Kur studentët dhe mësuesit fitojnë njohuri në lidhje me grupet e tjera dhe historitë e tyre, ata janë më të aftë të respektojnë anëtarët e këtyre grupeve dhe të bashkëpunojnë me ta. Duke tërhequr vëmendjen mbi proceset e diskriminimit, duke angazhuar në mënyrë aktive në ndërtimin e ekipit, dhe duke u konsultuar vazhdimisht me nxënësit të gjitha këto do të ndihmojnë në zhvillimin e një kulture të re tolerancë dhe mirëkuptimi.

Qasja e përvojës së deleguar. Në vend që nxënësve t'iu mësohen fakte të në lidhje me grupe të ndryshme, një program edukimi i ndër-grupit mund të përfshijë video - filma, drama, biografi, dhe mënyra të tjera për të paraqitur anëtarët e të gjitha grupeve në një mënyrë të respektueshme. Ekspozimi ndaj materialeve të tilla do të ndihmojë nxënësit të dallojnë gjërat e përbashkëta në të gjitha grupet dhe të zbehë prirjen e tyre për të vënë kufij të mprehtë midis “tyre” dhe “ne”. Efektiviteti i një qasjeje falë përvojë së deleguar varet nga mënyra se si paraqitet mesazhi i tolerancës. Një prezantim i varfër, në të cilin prezantuesi nuk e njej mirë materialin, apo përdor materiale të njëanshme, ose ka pak marrëdhënie me publikun, mund të rrisë paragjykimet në vend që t'i reduktojë ato.

Kontakte ndër-grupore. Një mënyrë në përmirësimin e marrëdhënieve të ndër-grupit është pjesëmarrja në aktivitete të përbashkëta. Kur njerëzit të bëjnë gjëra së bashku ata kanë mundësi të gjykojnë të tjerët në bazë të meritave e jo të stereotipave. Këto kontakte janë më të suksesshme në qoftë se njerëzit e përfshirë kanë të njëjtin status social, janë duke bashkëpunuar mbi diçka, në qoftë se veprimtaria e tyre është përkrahur nga njerëz në pozita autoriteti, dhe në qoftë se veprimtaria përfshin një nivel të lartë afriteti. Nëse aktivitetet janë organizuar në mënyrë të papërshtatshme, nxënësit e përfshirë në programet ndëretnike mund të krijojnë më shumë paragjykimë. Gjithashtu elemente kyç janë prindit, mësuesit dhe mbështetja e kolegëve në këto aktivitete. Marrëdhëniet midis grupeve ndikohen edhe nga strukturat dhe politikat shkollore. Për shembull,

Baker (1995) hulumtoi se si racizmi i institucionalizuar (në të cilat shkollat dhe institucionet e tjera themelore veprojnë, me qëllim apo pa qëllim, për t'iu mohuar mundësitë nxënësve të pakicave) ushqen imazhe negative të grupeve të caktuara dhe statusin e tyre vartës. Baker arrin në përfundimin se shkollat e integruara përqendrohen më shumë tek mësimi sesa shkollat e shteteve ku ka tensione dhe konflikte. Haley (1994) konstatoi gjithashtu, për shembull, se edhe pse kufij të fortë etnike ndajnë studentë të veçantë, integrimi sistematik dhe klasat me përmasa të vogla i ndihmojnë nxënësit t'i tejkalojnë kufijtë etnikë dhe për të arritur norma të larta diplomimi.

Promovimi i marrëdhënieve pozitive dhe ndër-grupore. Slavin (1995) ka konstatuar se në shkollat e organizuara tradicionalisht, ndërveprimi ndërmjet nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike ishte sipërfaqësor dhe shpesh konkurrues. Me përjashtim të sportit, nxënësit kishin pak kontakte pozitive në ose jashtë shkolle me anëtarë të grupeve të ndryshme. Përveç kësaj, Slavin tregon se metodat bashkëpunuese të të mësuarit mund të krijojnë mendime dhe ndërveprime të paanshme të cilat janë të nevojshme për promovimin e qëndrimeve racore pozitive. Në të mësuarin bashkëpunues, studentët e racave dhe etnive të ndryshme punojnë së bashku në grupe, duke marrë shpërblime, njohje, apo vlerësim në bazë të përmirësimit të performancës akademike të secilit anëtar. Mësimi në bashkëpunim ofron mundësi të përditshme për kontakt intensiv ndër personal ndërmjet nxënësve me prejardhje të ndryshme dhe është i strukturuar për t'i dhënë çdo nxënësi një mundësi për të kontribuar. Slavin konstatoi se kur përdoret siç duhet, mësimi bashkëpunues përmirëson qëndrimet dhe forcon marrëdhëniet miqësore të grupit. Metodat bashkëpunuese të të mësuarit gjithashtu kishin efekte pozitive në rezultatet shkollore, veçanërisht për studentët latinë dhe me ngjyrë.

